**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

**01 Nr. 11/22**
**Rahovec, 15.11.2022**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e njëmbëdhjetë (11) e cila do të mbahet më **25 nëntor 2022 (e premte)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës: P-02279-0, P-02280-0 dhe P-02281-0;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 1427 i datës 30.04.2019 për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi"
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për lirim nga pagesa e Mamografisë për të gjithë femrat e Komunës së Rahovecit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës Nr.P-71510057 -08924-0 personave fizik dhe juridik;
7. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimit;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Defrim Kafexhiu**

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.10.2022.** me fillim në ora **10:00.** Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i kuvendit z.**Defrim Kafexhiu.** Konstatoj se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar nënkryetar i komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, kjo është seanca e dhjetë për këtë vit kalendarik.

Atëherë KPF në mbledhjen e mbajtur më 19 tetor 2022 pas shyrtimit të pikave të rendit të ditës që janë propozuar nga kryesuesi i kuvendit në koordinim me kryetarin e komunës, ka propozuar këtë rendi dite me 13 pika;

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private për interes publik;**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i projekt statutit të QKMF-së;**
5. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ri-destinimin e mjeteve financiare nga buxheti i vitit 2022;**
6. **Shqyrtimi dhe miratim i vendimit për miratimin e projekt planit për trashëgimi kulturore 2022-2025;**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2027;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e programit komunal tre vjeçar për banim 2022 – 2025;**
10. **Shqyrtimi i raportit financiare për periudhën janar – shtator 2022;**
11. **Informatë për përgatitjen e vitit shkollor nga DKA-ja 2022/2023;**
12. **Shqyrtimi i raportit të performances komunale për vitin 2021;**
13. **Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 dhe diskutimi i planit të veprimit;**

**Kryesuesi** – Atëherë ky është rendi i ditës për sot, nëse dikush ka diçka për të thënë?...

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, përshëndetje ekzekutiv, asambleistë dhe të gjithë të pranishëm në këtë seancë. Në KPF e kam shprehur shqetësimin rreth raportit të zyrës së auditimit të brendshëm. Është një shkresë me dy faqe, nuk është raport. Në KPF kemi diskutuar edhe me nënkryetarin dhe në një farë forme erdhëm në seancë me një pajtueshmëri që duhet të jetë i bashkangjitur edhe raporti i auditorit të brendshëm. Unë nuk jam duke insistuar në këtë, me qëllim që performanca e komunës të dal keq, absolutisht çdo dokumentacion që duhet të shqyrtohet në asamblenë komunale e që komunën e Rahovecit e nxjerrë mirë në grantin e performancës jam i gatshëm ta mbështes tutje, por ky nuk është raport i auditorit – është informatë dy faqe. Si të tillë nuk mendoj që duhet të vazhdoi tutje në asamblenë komunale dhe kërkoj që pikën e 13-të të rendit të ditës ta shtyejmë për seancën e radhës dhe të shoqërohet bashkë me raportin e auditorit të brendshëm ose së paku raporti i auditorit të brendshëm të jetë në web-faqe sepse deri sot nuk është as në web-faqe të komunës e as nuk n'a është prezantuar neve si asamble komunale. Nuk besoj që ka aq të gjetuara sa që duhet t'i fshehim, ndoshta është neglizhencë dhe besoj që nuk është në rregull dhe goxha ofenduese për asamblenë me këtë shkresë dy faqe. Kërkoj të vendoset në propozim që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës që të vjen edhe raporti, pa dashtë të paragjykoj asnjë gjë në këtë drejtim.

**Nënkryetari** – Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar kuvendarë, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Tek pika e 13-të; shqyrtimi i raportit të zyrës së auditorit të brendshëm, në KPF kemi thënë që kërkohet një kriter rreth performancës komunale, sa i përket grantit kjo nuk ka ndikim, aty ndikim ka vetëm raporti i zyrës kombëtare të auditorit të jashtëm rreth fitimit të grantit. Përndryshe raportet e zyrës së auditorit të brendshëm nuk publikohen për aryes ligjore, ka pengesa ligjore dhe nuk kemi të drejtë t'i publikuar. Përndryshe secili prej jush që është i interesuar hiç pa çasje në dokumente zyrtare, mund të vie çoftë në zyre të kryetarit, nënkryetarit, të njësisë së auditimit të brendshëm t'i shoh të gjitha raportet e auditorit që i auditon drejtoritë dhe rekomandimet që iu jep, por edhe planet për zbatimin e rekomandimeve që iu japin drejtorive përkatëse. Ju jeni kuvend, nëse dëshironi ta vendosni ë votim për ta shtyrë për seancën tjetër, kryesuesi ka të drejtë ta vendos në votim, por unë iu ftoj të gjithëve që këtë pikë ta diskutoni për arsye të performancës komunale, sepse këtu jemi bashkarisht pavarësisht a jemi ekzekutiv apo legjislativ. E ftoj kryesuesin ta vendos si pikë të rendit të ditës, diskutohet si raport dhe ju ftoj që ta përkrahni për arsye të performancës komunale që kërkohet si kriter. Skenderi këtu është pjesë e grupit të performancës, mundet t'iu sqaroj më saktë arsyen se pse kjo kërkohet.

**Burim Krasniqi** – Nënkryetar, nuk e di pse duhet të shkojmë në zyre të kryetarit ta kërkojmë një raport i cili do të shqyrtohet sot dhe është dashur t' vie asambleistave?... Pa marrë parasysh formën e performancës, nuk tentojmë ta pengojmë. Unë e kam një pyetje ndryshe, a e vlerësoni si raport këtë shkresë?...Nuk është raport, është shkresë. Raporti i njësisë së auditimit të brendshëm është krejt ndryshe, për mua dhe për grupin e asambleistave të LDK-së nuk është raport.

**Nënkryetari** – Edhe një herë po e përmendi, është obligim ligjor që kjo të jetë si pikë e rendit të ditës, përndryshe për neve është raport dhe ky raport është bërë mbi bazën e një plani vjetor që e ka njësia e auditimit të brendshëm. Secili mund ta trajtojë si të don; raport, shkresë, informatë por unë e ftoj ushtruesin e detyrës së njësisë së auditimit të brendshëm z. Kabashin, nëse ka diçka për të thënë lidhur me këtë çështje.

**Kryesuesi** – Faleminderit, këtu vetëm një problem po e shoh, te pika e rendit të ditës si e fundit d.m.th vetëm ndryshimi i emërtimit (informatë e zyrës së auditimit), përndryshe si propozim i një anëtari të kuvendit unë do ta vendosi në votim. Atëherë pikën e 13-të të rendit të ditës sipas propozimit të Burim Krasniqit po e vendosim në votim për shtyerje për në seancën tjetër të rregullt, me çrast ky raport ose do të plotësohet ose do të ndryshohet emërtimi dhe të cilësohet si informatë. Kush është "për" shtyerjen e kësaj pike për në seancën tjetër?... Kundër?... Abstenim?... 11 vota për, 11 kundër dhe 1 abstenim. Atëherë kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancën tjetër, po e shfrytëzoj votën e dyfishtë. Atëherë rendi i ditës për seancën e sotshme i ka 12 pika, po e vendosim në votim si të tillë miratimin e rendit të ditës; Kush është për?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota për, 11 kundër, miratohet rendi i ditës me 12 pika. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës;

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** – A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit lidhur me procesverbalin nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e procesverbalit?... Me shumicë unanime miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**

**Edona Kryeziu** – Përshëndetje, faleminderit për mundësinë e fjalës kryesues, të nderuar të pranishëm, kolegë kuvendarë. Unë sot po iu drejtohem në emër të banorëve të fshatit Nagac, fshat ky i lënë pas dore sipas banorëve dhe vizitohet vetëm në kohë fushate. Në këtë fshat nuk është investuar asnjë cent për kanalizim, i gjithë rrjeti i kanalizimit që është i ndërtuar në këtë fshat nga ana e banorëve është pa kurrfarë kriteri e që është një pamje e tmerrshme në shekullin 21. Para dy viteve është vë gurthemeli i rregullimit të shtratit të lumit, në të cilin është paraparë të instalohen disa kolektorë për grumbullimin e rrjedhave të kanalizimit, e kuptojmë që rregullimi i tyre është i domosdoshëm për çdo lokalitet, mirëpo për këtë fshat është mjaftë jetik. Pothuajse të gjithë janë në dijeni që në këtë fshat është investuar shumë herë me participim sidomos tek shkolla fillore në faza të para të ndërtimit. Konsideroj që të bëhet edhe zgjidhja e këtij problemi me participim nga banorët, atëherë është e papërballueshme. Unë po iu drejtohem në emër të tyre, kërkoj nga drejtoria përkatëse që të bëhet një zgjidhje sa më e shpejtë dhe kur mund të presin banorët zgjidhjen e këtij problemi?...

**Sejfullah Sejfullahu** – Përshëndetje për të gjithë, nënkryetar, drejtora, kuvendarë. Ditë më parë ose më shumë se një muaj, në të përditshmen dhe mjaftë të lexuarën " Vecernje Vijesti" është dhënë një deklaratë ose infromatë apo sulm që iu është bërë verërave dhe vreshtarisë tonë. Prej pesë verërave të testuara të Kosovës, katër prej tyre kanë rezultuar fals. Ajo që më preukupon mua është heshtja jonë edhe pse nuk po them që ndoshta i kemi të gjitha kompetencat që t'i kundërvihemi ose t'i padisim, por kjo heshtje nuk është e mirë as e jona as e agjencisë së ushqimit dhe veterinës e gjithashtu as e ministrisë së bujqësisë rreth këtij sulmi që është bërë. Të gjithë e dijmë që verërat tona janë më të mirat në rajon të vlerësuar nga gazetarë, presidentë, ambasadorë të gjithë i kanë cilësuar si më të mirat. Ky sulm është shumë i dëmshëm dhe nuk e di si duhet të reagojmë. Kroacia është shtet mik i joni, por a lejohet një sulm i tillë që për interesa të ngushta të vendeve të ekonomisë të rajonit të na bëhet neve. Të gjithë e dijmë që është një kamuflim, shantazh apo një luftë ndaj verës tonë. Ftoj kryetarin, nënkryetarin dhe juve kryesues që ta shikoni bazën ligjore dhe në fund nuk është turp edhe t'i padisim. Mendoj që duhet të reagojmë, i kam shfletuar të gjitha portalet e rajonit dhe nuk ka vend që nuk është shpërndarë dhe nuk ka reflektuar kjo informatë prandaj ju ftoj që ta mbrojmë prodhimin tonë. Po thonë ka qenë "sheqer dhe ujë" si konsumues i rregullt i verës së Rahovecit, ose unë do ta merrja "sheqerin" ose askush, para tre dite e kam matur sheqerin, 5.8 e kam. Pres reflektim prej organeve.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë. Realisht kam dy pyetje, për ekzekutivin dhe kryetarin më konkretisht. Para dy jave është nënshkruar një momerandum mirëkuptimi me ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për një projekt kryesor për këto pesë fshatra; Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushe e Madhe, Hoçë e Madhe. Projekti është nënshkruar në vlerën prej 60.000euro. Nuk e di për çka janë paraparë këto mjete, por mund të them që me 60.000euro mund të bëhet vetëm ndonjë pastrim të këtij lumi edhe pse është nevojë esenciale të bëhet edhe pastrimi. Një çështje tjetër është prapë në fshatin Brestoc; Kur e kam pyetur kryetarin lidhur me rrugën në fshatin Brestoc, ai është përgjigjur që është kompetencë e ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kryetarin ose drejtorin desha ta pyes; A e ka diskutuar çështjen e shembjes së rrugës në fshatin Brestoc, e cila është bërë e rrezikshme për banorët dhe për njerëzit që lëvizin në atë pjesë.

**Besmire Bytyqi** – Faleminnderit kryesues. I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë. E kam një pyetje, duke qenë që jemi në muajin tetor – muajin e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, e kemi parë lajmin që mamografia këtë muaj do të jetë falas, ndërsa interesi i grave të komunës sonë ka qenë jashtëzakonisht i madh. Duke qenë se në QKMF nuk kanë arritur t'i përfundojnë të gjitha ato gra që janë lajmëruar me terminet e tyre. Pyetja është; A do të vazhdohet edhe muajve të ardhshëm të jetë pa pagesë derisa lista e grave që kanë bërë termin të përfundoj?...

**Burim Krasniqi** – Faleminderit edhe një herë kryesues. Deshta të bëj pyetje të ngjajshme me Besën, por po e them pak më ndyshe. Është fakt që është muaji i vetëdijesimit ose ndërgjegjësimit të grave për luftimin e kancerit të gjirit dhe është fakt që ka ekzistuar një postim në fb si ftesë për të shkuar gratë ta bëjnë mamografinë. Fakti i dytë është që për dy javë tjera pas kësaj nuk ka punuar mamografia, pse?... Sepse

operatorit që e bën mirëmbajtjen e saj, komuna ia ka pasur 30.000euro borgj (nëse nuk gaboj) dhe nuk ka ardhur për servisim. Prej datës kur është bërë postimi në fb, në cilën datë është mamografia e parë?... Në atë ditë ose të nesërmen a ka pasë mamografi?...Jo, sepse nuk ka punuar, e kam me argument, bile të njëjtën kohë nuk ka patur as film për rengën. Për dy javë pacientët janë kthyer sepse nuk ka film të rengenit. Drejtor i financave, po të kërkoj miqësisht që të jem të kujdesshëm te pjesa e shëndetësisë sepse nuk guxojmë të mbesim në obligime e qytetarët të "zhagiten" që për shkak mospagesësë së obligimeve nuk arrijnë t'i kryejnë këto shërbime. Një shqetësim tjetër edhe pse drejtoresha e shëndetësisë nuk qenka këtu, pse nuk punon pajisja e rengenit kur nuk ka rrymë?... Me sy të mi e kam parë që pacientët kthehen me arsye që gjeneratori nuk e vë në funksion rengenin!. Kërkoj ta gjejmë mirëkuptimin ose ta bleni një gjenerator tjetër që është i aftë t'i vë në funksion të gjitha pajisjet komplet të QKMF-së në Rahovec që qytetarët tanë kurdo që vijnë t'i kryejnë shërbimet e tyre. Në KPF e kam bërë pyetjen rreth buxhetit dhe çështjes së furnizimit me lëndë djegëse. Në këtë drejtim i kam dy pyetje; E para, sasia e kontraktuar e lëndës djegëse, a është ajo që është kërkuar prej shkollave dhe a e mbulon furnizimin me lëndë djegëse për të gjitha shkollat, për të gjithë periudhën mësimore që do të zhvillohet, duke patur parasysh që do të ketë mësim më gjatë sesa herave tjera gjatë dimrit. E dyta, kontrata a është një vjeçare apo më shumë, duke patur parasysh që sivjet e kemi një vit specifik ku çmimi i lëndëve djegëse është 200% më i shtrenjtë. Është ndërprerë një kontratë me operatorin e njejtë për shkak të ndryshimeve në çmim e që është logjike dhe normale, por në çoftëse është ndërprerë kontrata sivjet për shkak të rritjes së çmimeve besoj që nuk bënë me qenë më shumë se një vjeçare kontrata e furnizimit me lendë djegëse sepse dëmton direkt buxhetin e komunës. E kam bërë një pyetje për drejtorin e DKA-së rreth konkurseve me gjysëm normë dhe nuk kam marrë kurrë përgjigje, shpresoj që nuk e keni lënë në harresë dhe shpresoj që në seancën e radhës ta kemi informatën.

**Melinda Oruqi** – Përshëndetje për të gjithë, te unë janë ankuar shumë qytetarë. Rruga në dalje të Rahovecit, përkatësisht shtegu i ecjes te pjesa e quajtur "Zhdredhë", kam qenë edhe personalisht i kam bërë disa foto aty dhe ajo rrugë është shëndërruar në një tmerr nga vërshimet e shiut. Zakonisht gjatë vikendeve aty dalin shumë familjarë për të ecur. Kërkoj nga drejtoria e Shërbimeve Publike ta riparoj këtë shteg.

**Vlora Vuçitërna** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Kohëve të fundit po shohim vetëm projekte për sheshe, së fundmi edhe një shesh tjetër në lagjen time i emërtuar si "Sheshi i Republikës" shpresojmë që këtë projekte do të përfundojnë mirë dhe së shpejti. Unë si prind dhe prindërit tjerë e kemi një brengë tjetër sepse në një ditë vikendi nuk kanë ku t'i dërgojnë fëmijët për disa orë për aktivitet dhe rekreacion. Jemi në dijeni se te Maja e Shkodranit janë vendosur disa lodra, mirëpo duhet pasur parasysh që josecili e kemi atë mundësi t'i hipim makinës e të shkojmë deri atje lartë. Nënkryetar, po iu drejtohem juve, meqenëse kryetari nuk është këtu; A planifikoni së shpejti ndonjë projekt për fëmijët tanë, apo do të ende me projekte për sheshe?... E dyta; Kësaj here e kam një kritikë për drejtorinë e arsimit. Drejtor, nuk e di a jeni duke dalur për vizitë në shkollat e qytetetit apo jo, mirëpo meqenëse shkollat janë edukativo-arsimor, mendoj që pastërtia duhet në nivel maksimal. Kërkoj falje që duhet të shprehem kshtu, por momenti i hyrjes nëpër objekte të shkollave në qytet ta jep ndjenjën që je në një toalet publik. Mendoj që drejtoria e arsimit duhet të merr masa çoftë me stafin që është, çoftë edhe të shtoj numër të stafit për mirëmbajtje të pastërtisë.

**Merisa Sharku** – Përshëndetje për të gjithë. Po i drejtohem së pari drejtorisë së urbanizmit; Kemi kërkesë për reagim nga komuniteti i arkitektëve të komunës sonë; Gjatë aplikimit për leje ndërtimore, përgjigja po bëhet e tejzgjatur në kushte ndërtimore, kjo kërkesë vjen drejtpërdrejt prej arkitektëve. Disa herë më parë e kam cekur që qytetarëve duhet t'i bëjmë stimulim për të marrur leje ndërtimorem, në këto raste kur po ndodhin këto zhagitje, demotivohen për aplikim për leje ndërtimore. Në emër të arkitektëve po bëj thirrje për reagim, përgjigjet për kushtet ndërtimore dhe leje ndërtimore të vijnë më shpejtë. Pika tjetër që dua të lidhem është ajo për "Sheshin e Republikës"; Vlora e ceku që po bëhen shumë sheshe, po e potencoj që më mirë mos me u bë një punë, sesa të bëhet në mënyrë të gabuar. Reagimi që ka qenë për në sheshin në qendër me arsyen që është dashur të konsultohemi me eksperta më detajisht rreth projektit, e tash përveç që nuk ka patur asnjë konsultim për këtë shesh, këtu po ndodhin edhe krime!. Nuk e di sa jeni të informuar, por të rrënohet trashëgimia

kulturore të një qyteti është krim. Aty qytetarët e dijnë që ka qenë kroi i vjetër i qytetit, këtu reagim ka patur prej përgjegjësve të trashëgimisë kulturo – historike të Rahovecit (ish- përgjegjësve). Ata kanë bërë kritikë dhe reagim të ashpër për këto krime që po ndodhin në këto pjesë të qytetit. Trashëgimia duhet të ruhet – jo të rrënohet, më mirë mos e bëni një punë sesa të rrënohet.

**Nënkryetari** – Faleminderit kryesues. Pyetja e fundit, projekti "Sheshi i Republikës"; Është e vërtetë që ka filluar aty një projekt, është shumë i mirë, dikush mendon që është shumë i mirë e dikush tjetër jo. Për të gjitha krimet që mendon dikush që janë bërë në ekzekutim të projekteve, janë organet tjera që mund të i drejtohet secili prej juve, i ftoj edhe qytetarët tjerë t'i bashkohen kësaj. Ndoshta ka pasë deklarata që tani po i marr vesh, rreth rrënimit – demolimit të kroit të vjetër gjë që nuk është e vertetë, kroi bashkë me "koritën" e vjetër janë aty. Do të kujdesemi që edhe ujin ta sigurojmë dhe kjo "qeshme" të jetë funksionale. Pyetja e dytë, te kushtet ndërtimore dhe lejet ndërtimore; ju ftoj të gjithë juve t'i ftoni njerëzit të marrin leje ndërtimore dhe ju siguroj që drejtoria e urbanizmit do të përgjigjet në afatet ligjore që janë. Tek asambleistja, znj. Vlora Vuçitërna rreth projekteve të rekreacionit për fëmijë, edhe unë jam prind dhe i kuptoj këto gjëra. Investimet ndodhin prej komunës, a janë të mjaftueshme? Ju siguroj që jo, mirëpo kemi projekte, janë rregulluar disa parqe që mund të frekuentojnë fëmijët, ndoshta kemi mungesë të përgjithshëm të trajtimit të atyre parqeve në kuptimin e demolimit të prishjes pa arsye. Te asambleistja Melinda Oruqi Iska rreth shtegut të ecjes që është demoluar nga vërshimet, komuna ka projekt dhe do të bisedojmë dhe ta shohim se çka mund të intervenojmë për sivjet. Te asambleisti Burim Krasniqi rreth mamografisë dhe muajit të vetëdijesimit; Është e vërtetë që mamografia është prishë është aparat dhe aparatet prishen, mirëpo të nesërmen menjëherë është rregulluar problemi dhe ka vazhduar puna me mamografi dhe aq më mirë ku edhe të shtuneve ka vazhduar puna. Te furnizimi me lendë djegëse nëpër shkolla; Është e vertetë që ka qenë një kontratë dhe është prishur, ju e dini se çmimet janë rritur dhe të gjithë i kuptojmë këto gjëra, është lidhur një kontratë e re dhe furnizohen shkollat mbi bazën e kërkesave që i kanë. I ftoj gjithë drejtorat e shkollave që mos t'i pranojnë lëndët djegëse nëse nuk janë në metrazhë mbi bazën e kërkesës që është kërkuar dhe nënshkruar. Te asambleistja Besë Bytyqi, mamografia të jetë pa pagesë. Në këtë muaj të ndërgjegjësimit është pa pagesë. Bisedova edhe me drejtorin e QKMF-së Albunitin dhe kjo tarifë prej 5euro është e paraparë me udhëzim administrativ, do të kujdesemi nëse eventualisht ekziston ndonjë mundësi me vendim të kryetarit, çoftë edhe me vendim të kuvendit unë jam për që të lirohen nga kjo taksë secili pacientë që trajtohet me mamografi. Te asambleisti Lirigzon Kastrati, rreth memorandumit që është nënshkruar prej ministrit të Planifikimit Hapësinor dhe kryetarit të komunës për projektin e rregullimit të lumit Hoçë e Madhe – Krushë e Madhe. Projekti është lidhur me dy llote në vlerë prej 1.294.000 ndërsa memorandumi është nënshkruar vetëm për 60.000euro dhe këto janë mjete që të shpenzohen vetëm për këtë vit. Punët kanë përfunduar 20%, është projekt i ministrisë dhe jo i komunës. Te pyetje tjetër, në Brestoc – rruga që paraqet rrezik, unë vet kaloj aty, prapë është kompetencë e ministrisë dhe nuk ka të drejtë komuna të investoj pavarësisht rrezikut. Ne iu kemi drejtuar ministrisë së infrastrukturës shumë herë që ta trajtoj këtë problematikë e cila sinqerisht paraqet rrezik. Tek asambleisti Sejfullah Sejfullahu rreth artikullit që po qarkullon në lajmet dhe portalet tona. Nuk e di sa jemi kompetentë ne të reagojmë përderisa i kemi institucionet qëndrore respektivisht ministrinë e bujqësisë. Ne po se po, krytari i komunës gjithashtu por është ministria e bujqësisë, është një shoqatë e verëtarëve, është një institut atje që është dashur të reagoj së pari dhe më pas kryetari i komunës që i mbron interest e bizneseve që operojnë në territorin e komunës tonë. Besoj që ke të drejtë dhe besoj që artikulli ka qenë tendenciozë për shkak të interesave të disa bizneseve që afarojnë në Kroaci. Tek asambleistja, zonjusha Edona Kryeziu rreth kanalizimit në Nagac që lidhet me lumin Brestoc – Krushë e Madhe, është një kontratë me kanalizime e cila do të përfundoj, nuk e di tjetër çka të shtoj rreth kësaj, përpos asaj që përcaktohen prioritetet mbi bazën e shpërndarjes së buxhetit komunal.

**Afrim Limani** – Pasi Burimi e lakoj emrin tim, dola t'i jap përgjigje. Nuk është e vërtet dhe nuk qëndron ajo që ne i kemi borgj operatorit ekonomik i cili merret me mirëmbajtjen dhe servisimin e aparatit mjekësor. Ky shpenzim kryehet nga kategoria mallra dhe shërbime për shkak të keqklasifikimit. Ne nuk kemi mundësi që pagesën ta kryejmë në mënyrë të menjëhershme, mirëpo pagesën e kryejmë muaj për muaj, mund të them që

sa ndoshta ia kemi 5000euro borxh dhe vazhdimisht për çdo muaj operatorit në fjal ia kemi bërë pagesën. Sot tdo ta kesh emailin me të gjitha fletëpagesa dhe gjendjen e operatorit në fjalë sepse ajo informatë që e the nuk është e qëndrueshme dhe nuk është e vertetë. Pyetja tjetër ishte rreth furnizimit me lëndë djegëse në shkolla. Kontrata është një vjeçare e cila na ka goditur në aspektin e buxhetit për shkak të ngritjes së çmimeve sepse në kontratën e parë çmimi për metër dru ishte 42euro, ndërsa tani e kemi 82euro. Shkollat kanë furnizim mjaftë dhe nuk është problem për lëndë djegëse dhe nuk rrezikojnë për mosfurnizim.

**Burim Krasniqi** – Drejtor, me thënë "nuk është e vërtetë" i bie që i thua dikujt "po rren" dhe është goxha term i rëndë. E dyta; Unë kam rast në familje me problem të kancerit të gjirit që ka kërkuar t'i kryej shërbimet e mamografisë dhe mamografia nuk ka punuar. Jam i interesuar pse nuk po punon?... Nuk punon se operatori nuk vjen për servisim pa ia paguar 30.000euro, kjo është informatë nga zyrtarët e QKMF-së në Rahovec. Në këtë rast ose unë po e them të pavërtetën, ose dikush nga QKMF ose ti po e thua. Kemi patur nevoj për shërbim të mamografisë, nuk ka punuar pas daljes së fotografisë ndoshta 10 ditë ose 2 javë. Drejtor, e kam një kërkesë direkte, për seancën tjetër në asamble të na tregoni raportin se kur është bërë mamografia e parë prej ditës së vetëdijesimit të kancerit të gjirit, prej protokolit që e keni regjistruar sepse unë jam i kujdesshëm në atë që e them dhe nuk ka dalur këtu për të shpifur sepse kemi pas shumë nevoj si familje ta kryejmë mamografinë dhe nuk e kemi marrë shërbimin.Në QKMF ose nuk ka patur pagesë të serviserit ose nuk ka dashur të kryejnë shërbime. Do zoti nuk sprovoheni në familje se e shihni vet në çfarë situate do vini, kur të keni situata të tilla.

**Afrim Limani** – Burim, atë që e thash unë mund ta vërtetosh brenda dy orëve. Nuk thash që nuk i kemi borxh, por vazhdimisht operatorit në fjalë i kemi bë pagesa. Nuk mundemi në mënyrë të menjëhershme sepse ky planifikim i buxhetit bëhet nga kategoria mallra dhe shërbime për shkak të keqklasifikimeve që i kemi diskutuar. Maksimumi brenda 2 ore e ke në email kartelën e operatorit në fjalë se sa ia kemi paguar, sa ia kemi borxh dhe kur ia kemi paguar.

**Nënkryetari** – Nuk dua të lidhem me atë a është paguar operatori apo jo, por kjo është paisje (telefoni) dhe prishet, vjen tjetri e rregullon. Ashtu siç thua ti është prishë aparati i mamografisë dhe operatori ka ardh për servisim dhe menjëherë të nesërmen ka filluar puna me mamografi. Vonesat duhet t'i mirëkuptojmë sepse serviseri nuk qëndron aty që në momentin e prishjes ta rregulloj menjëherë, me rendësi është që të nesërmen ka filluar puna menjëherë dhe shumë më mirë që është punuar edhe të shtuneve në këtë drejtim.

**Sejfullah Sejfullahu** – Nënkryetar të mbeta borxh për sqarim. Më parë e the që duhet të bëjmë presion te organet qëndrore. Por nëse nuk kemi ne kompetenca për verë, nuk e di atëherë çfare i kemi, për ngrohjen globale apo armatimin bërthamor nuk flasim, por thjesht për tema të vreshtarëve dhe është mirë që ta bëjmë një deklaratë me baza ligjore sepse është një prej revistave më të lexuara në Kroaci dhe jashtë saj. E kam parë edhe reagimin e vreshtarëve por më tutje nuk është bërë asgjë. Fatkeqësisht në aspektin filozofik heshtja merret si pohim.

**Nënkryetari** – Qëllimi jonë është t'i mbrojmë prodhuesit tanë të verës dhe vera është produkt i mbrojtur nga shteti, besoj që duhet të kemi dakordim me ministrinë e bujqësisë dhe të merret vesh se kush ka dalur me këtë deklaratë, institucionet shtetërore atje, apo ndonjë bodrum.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, pajtohem plotësisht me kolegun Sejfullah Sejfullahu që me të vërtetë duhet të mbrohen prodhuesit tanë. Unë kam një replikë për përgjigjen e nënkryetarit. Nënkryetar, projektin për rregullimin e shtratit të lumit e zhvillon komuna e Rahovecit, është e vertetë që është me bashkëfinancim, mirëpo tani e 2-3 vite nuk është bërë asnjë investim. Pak më herët e potencova që është një ndër projektet kryesore që i lidh këto 5 fshatra dhe vetëm po iu them një këshillë që në këtë projekt punoni më seriozisht dhe të implementohet brenda afatit të përcaktuar.

**Nënkryetari** – Lirigzon, sa për informatë ky projekt financohet vetëm prej ministrisë, nuk ka bashkëfinancim. Këtu ka financim të plotë vetëm prej ministrisë, ndërsa komuna i mbikëqyr punimet.

**Merisa Sharku** – Sa i përket çështjes për drejtorinë e urbanizmit, nuk e di a është e nevojshme t'i citoj fjalët e arkitektëve që më kanë shkruar direkt, ka ndodh vonesa diku rreth 20 ditë, pas pauzës do t'ju tregoj se kur e ka bërë pagesën për aplikim për kushte urbanistike. Sa i përket trashëgimisë kulturore nuk e di ku e gjeni kurajon

për reagim. Në pjesën e parë e bëra një reagim të butë, por nuk e di sa jeni në dijeni që trashëgiminë kulturore në Rahoveci e keni në pikën zero. Trashëgimia është dëmtuar tejmase – e keni shkartuar totalisht. Mbulimi me rrasa apo rivendosja e një qeshmë të re në vend të një kroi të vjetër 250 vjet nuk quhet ruajte e trashëgimisë kulturore, por nuk keni faj sepse nuk konsultoheni me eksperta. Për ta bërë ruajtjen e trashëgimisë kulturore duhet të vijnë eksperta të restaurimit (se di a keni dëgju këtë fjalë ndonjëherë). Trashëgimia kërkon restaurim, jo rrënim të një monumenti historik, më pas t'i thirrni muratorët për ta punuar me tulla apo rrasa. I kemi fotot, nuk e di nëse mundet dikush të më tregoj diçka ndryshe që ka ndodhur, përveç që është ndërtuar një qeshmë e re. Këtu shihet që është ndërtuar një qeshme e re dhe jo restaurim i qeshmes aktuale që ka qenë aty. Sot nuk e ka marrur me veti dokumentacionin e plotë me rrënimin e komplet krojeve të qytetit të Rahovecit, sepse nuk e ka pritë që guxoni të reagoni, komplet krojet e Rahovecit janë mbuluar me rrasa dhe beton. Në seancën tjetër vij me dokumentacion – foto dhe nuk e di si mund ta kundërshtoni një gjë që është faktike.

**Drilon Mustafa** – Atëherë përshëndetje për të gjithë. Deshta të ndërlidhem pak te shqetësimi i Merisës. Realisht në Kosovë nuk ka eksperta të restaurimit. Restaurimi është shkencë d.m.th çdo kush mund ta mësoj edhe unë si arkitekt dhe të gjithë të tjerët. Përndryshe rreth këtyre qeshmeve që janë; Nëse ka argumente, restaurimi d.m.th nëse diçka është prishur – e zëvendëson me një material tjetër. Këto qeshme zakonisht kanë qenë të rrënuara krejt. Nëse ka argumente që kjo qeshme ka qenë e ngritur, e kemi hequr një guri e kemi vë një guri tjetër ose një material tjetër, atëherë kjo quhet renovim. Përndryshe restaurimi ka të bëjë me përshtatjen e materialit që është përdorur në një kohë të caktuar, sigurisht që nuk mund të gjejmë material që është përdorur para 1200-1300 viteve, por mund ta gjejmë llaqin e përshtatshëm që ta përdorim. Kryesorja është t'ia ruajmë formën dhe nëse është rrënuar duhet ta zëvendësojmë me material adekuat, përndryshe këto qeshme kanë qenë të rrënuara komplet, e kanë një bazë të betonit që mund t'ia heqim rrasat ta shikojmë dhe nëse ka argumente që institucionet përgjegjëse e kanë rrënuar atë që ka qenë ose e kanë zëvendësuar me materiale të ndryshme nga atë që kanë qenë është okej. Përndryshme një objekt që është i rrënuar nuk mund të restaurohet, me restaurim mund t'i mbyllim disa gjurmë të caktuara dhe duhet të mundohemi t'ia përshtatim materialin në kohën e caktuar që ka qenë.

**Kryesuesi** – Faleminderit Merisa, nëse dikush tjetër nuk ka diçka për ndonjë çështje tjetër, po e përfundojmë këtë diskutim dhe pikën e dytë të rendit të ditës, para se të vazhdojmë me pikë e tretë, po e marrin një pauzë prej 5 minutave, rikthehemi.

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private për interes publik;**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues. I nderuar nënkryetar, kolegë drejtora, të nderuar anëtarë të kuvendit. Sipas ligjeve dhe rregulloreve tjera, kryetari i komunës propozon për juve që të merrni pëlqim për këmbim të pronës publike me pronë private, të dyja këto prona gjenden në zonën kadastrale në Rahovec; Bëhet fjalë për pronën publike me nr. 2186 – 0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 5ari e 6 metra katror. Ne ju propozojmë juve që kësaj pjese prej 5 ari e 6 metra katror t'i merret pjesa me sipërfaqe prej 64 m katror me qëllim të hapjes së rrugës publike dhe kjo sipërfaqe t'i jepet pronarit Sylejman Halit Durguti dhe pjesës ku pronar është i njëjti Sylejman Halit Durguti me nr. 2034 – 2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 32 ari e 5m katror t'i mirret prej pjesës së përgjithshme sipërfaqja prej 64m katror dhe t'i jepet pronës shtetërore të Kosovës me qëllim të vetëm të hapjes së rrugës publike. Sipas PZHK-së të dyja këtë parcela bëjnë pjesë në zonë ndërtimore. Në material e keni një raport të formuar nga kryetari i komunës, një komision i cili ka dalë në vend – ka bërë raport në lidhje me vlefshmërinë e këtyre parcelave, parcelat janë të barazvlefshme. Kërkojmë nga ju që të këmbejmë pronën publike me private me sipërfaqe të njejtë prej 64m katror.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor. A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo atëherë po e vendosim në votim. Kush është për miratimin e këtij vendimi?... Me shumicë unanime miratohet propozim vendimi për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me atë private për interes publik.

4. **Shqyrtimi dhe miratimi i projekt statutit të QKMF-së;**

**Elbunit Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë. I nderuar nënkryetar i komunës, kryesues i kuvendit, drejtorë, asambleistë të nderuar. I kam disa përgjigje dhe çështje që janë ngritur rreth statutit. Çështja e parë ka qenë për maternitet; Në statut shkruhet qartë që QKMF "Fahredin Hoti" posedon maternitetin që nga viti 1988 që është njësi e departamentit të mjekësisë familjare siç janë edhe urologjia, pediatria dhe vaksinimi. Rreth ndryshimit që është kërkuar për heqjen së zyrës së prokurimit; Ministria përkatësisht departamenti ka kthyer përgjigje dhe në statut nuk figuron zyra e prokurimit në QKMF. Çështja e zgjedhjes së zv.drejtorit është e rregulluar me udhëzimin administrativ 04/2020 dhe vlen njëkohësisht për të gjitha komunat e republikës së Kosovës. Sa i përket ultrazërit; Specialisti i mjekësisë familjare gjatë specializimit (edhe vet jam specializant i mjekësisë familjare) i kryen modulet ku aplikohet ultrazëri, faktikisht nëse je specialisht i mjekësisë familjare ti je i aftë ta aplikosh ultrazërin, se sa e aplikon, apo nuk e aplikon është në dorë të mjekut dhe prandaj thuhet në statut që specialisti i mjekësisë familjare duhet të dijë të përdorë ultrazërin.

**Burim Krasniqi** – Po nisna prej të fundit, thotë; Mjeku familjarë duhet të jetë i certifikuar. Kam kërkuar që fjala "certifikatë" mos me qenë në statut sepse gjatë studimeve nuk merr certifikatë për përdorim të ultrazërit. Është përvoj që fitohet, aftësi profesionale por jo certifikatë. Mjekët që jeni aty nuk e besoj që dikush ka certifikatë të miratuar prej odës së mjekëve, kjo na vë në sfidë nesër në zbatimin e statutit, këtu është problemi kryesor, që duhet të jetë i aftë ta përdorë ultrazërin nuk diskutohet ajo punë, por fjala certifikatë nuk besoj që e ka vendin këtu. Nuk e di çfarë statuti e keni ju drejtor, por këtu te unë është e kjartë që figuron zyra e prokurimit. Organizimi i QKMF-së paragrafi 1, neni 1, pika 1.2.4 thotë; Njësia ose zëra e prokurimit, këtu figuron. Nëse thua që duhet me heq, në rregull bëhet ndryshimi kur miratohet statute i QKMF-së. Te çështja e maternitetit; Ne e kemi një QKMF nuk i kemi dy dhe si e tillë nuk duhet më qenë; Në QKMF-të ku funksionon materniteti është i domosdoshëm, por duhet të potencohet te shërbimet te neni 6, pika 5 te lista; Specialist i mjekësisë familjare, stomatolog etj… duhet me qenë gjinekologu, neunatologu dhe pediatric dhe te ofrimi i shërbimeve duhet të ceket p.sh ofron shërbime gjinekologjike. D.m.th paragrafi 6 i nenit 6 të largohet, sepse udhëzimi administrative ta mundëson dhe në statut duhet të specifikohet se çka ofron. Kjo pike jo të hiqet, jo të hiqet shërbimi gjinekologjik por të specifikohet te çdo mjek specialist. Te ofrimi i shërbimeve; përveq shërbimeve tjera të specifikohen shërbimet dhe të rregullohet kjo çështje kjartë. Te çështja e zv. drejtorit; Ka ngatërresa, detyrat e zv. drejtorit në statut nuk janë askund. Te neni 13, te drejtori i QKMF-së është një gabim teknik, pika 5 thotë; zv. drejtori ndihmon në ushtrimin e detyrave të përditshme dhe vepron dhe vepron në emër të drejtorit në mungesën e tij. D.m.th duhet të specifikohet çështja e zv. drejtorit, e di që është shumë e rendësishme që statuti të kaloj, për të rregulluar çështjen e organizimit të brendshëm dhe të funksionoj më mirë QKMF-ja, por besoj që kjo duhet të rregullohet dhe neni 14 të përmirësohet paragrafi 4; Procedurat e emërimit të drejtorit – në paragrafin 4 është; procedurat për përzgjedhjen e zv. drejtorit e udhëhet drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale d.m.th a është për zv. drejtorin apo për drejtorin?... Një pyetje të fundit; Te neni 6, paragrafi 5 thotë; Specialist i biokimisë, infermier/re i diplomuar, nuk parashihet teknin i infermierisë dhe teknik medicional. Janë të punësuar me shkollë të mesme të mjekësisë, a nënkupton kjo qe këta njerëz duhet të shkarkohen prej punës sepse nuk parashihen këtu. Mendoj që duhet të shtohet edhe teknik infermierisë edhe teknik i mjekësisë sepse i nxjerr problem vetvetes si drejtor dhe menaxhmentit në të ardhmen. Kërkoj që të specifikohet pozicioni i gjinekolokut, neanotologut dhe pediatrit te neni 6 paragrafi 5. Të specifikohet te shërbimet ofrojnë p.sh; është njësia e gjinekologjisë. Kërkoj që te neni 5 të përfshihen teknikë të infermierisë dhe teknikë medicional. Te neni 9 te organizimi i QKMF-së të potencohet sektori ose njësia e maternitetit. Te neni 14 të hiqet fjalia; Procedurat për përzgjedhjen e zv. drejtorit por duhet me qenë; Procedurat e përzgjedhjes së drejtorit sepse bëhet fjalë për drejtorin dhe jo për zv. drejtorin.

**Elbunit Kryeziu** – Po filloj me çështjen e (teknik infermieri) është neni 5.13 përfundi radiologut shkruan; Profesionistët shëndetësor të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë të përcaktohet në regjistrin zyrtarë të ministrisë, këtu hyjnë teknikët infermierorë që janë me shkollë të mesme dhe është e përcaktuar me ligj. Te çështja e ultrazërit për certifikim; Në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional mundet që institucioni

(QKMF-ja) mjekun familjar nëse e parasheh të nevojshme të ketë trajnime shtesë të ultrazërit ta dërgoj brenda ose jasht shtetit për trajnim dhe kjo certifikat njihet gjithashtu nga oda e mjekëve. Zyra e prokurimit është hequr nga statuti, por ndoshta është edhe gabim teknik. Për specifikimin e gjinekologut; QKMF-ja duhet të ketë materniteti, gjinekologun e ka, kur e ka maternitetin duhet ta ketë patjetër edhe neunatologun, duhet të specifikohet edhe kjo ndoshta është statuti me gabime teknike që është përcjellur te ju, përndryshe të gjitha këto që i përmenda kanë ardhur prej ministrisë si të aprovuara.

**Kryesuesi** – Drejtor, këto propozime që erdhën prej anëtarit të kuvendit, a janë në përputhje apo ka diçka që nuk bën të vendoset në votim.

**Elbunit Kryeziu** – Përveq propozimit për teknik infermieror që e specifikon shumë qartë statuti, e që hyjnë tek profesionistat tjerë shëndetësor me shkollim të mesëm apo të lartë, kjo pjesë nuk mund të shtohet në statut, ndërsa tjerat janë në rregull.

**Kryesuesi** – Atëherë e kemi një propozim nga shefi i grupit të LDK-së rreth ndryshimeve në statutin e QKMF-së. Fillimisht po e vendosim në votim propozimin për ndryshimet e lartëcekura. Kush është Për?...Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 16 vota për dhe 11 kundër kalon propozimi i Burim Krasniqit. Nëse dikush tjetër nuk ka diçka për të thënë rreth statutit?... Atëherë po e vendosim në votim pikën e 4 të rendit të ditës bashkë me propozimet që kaluan. Kush është për?... Me shumicë unanime miratohet projekt statuti i QKMF-së.

**5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për ri-destinimin e mjeteve financiare nga buxheti i vitit 2022;**

**Afrim Limani** – Në mbështetje të ligjit të financave publike dhe përgjegjësive, kryesisht neni 30 pika 2, e kemi shfrytëzuar këtë nen për shkak të natyrës së projekteve dhe specifikave të tjera kemi konstatuar se këto projekte rrezikohen të kalojnë në suficit dhe atëherë kemi shfrytëzuar mundësinë për ta përdorur këtë proces dhe kemi bërë një plan të shpërndarjes së këtyre mjeteve duke u ridestinuar në kuadër të projekteve të ndryshme. Shuma e mjeteve të parapara për ridestinim është 175.608euro, kryesisht në kuadër të 4 drejtorive; Drejtoria e shërbimeve publike, ekonomi – turizëm, urbanizëm dhe arsim. Investimi i zonës ekonomike në Opterushë, e kemi një shumë prej 30.000euro që e kemi menduar ta bartim në projekte me donatorë. Kjo pjesë e mjeteve është si rezultat i krijimit të një marrëveshje që e kemi bërë me ministrinë e industrisë dhe tregtisë, ata plotësisht e financojnë projektin dhe detyrë e jona është të investojmë në pjesën e hartimit të projekteve. Në këtë projekt të planifikuara kemi patur 60.000euro, 30.000 janë ndarë për ridestimin, ndërsa pjesa tjetër për hartimin e projekteve. Në investime në turizëm dhe shtigje të ecjes është një shumë e mjeteve e cila ka mbetur si rezultat i mungesës të ndonjë projekti adekuat brenda këtij viti për t'i shfrytëzuar këto mjete të cilat janë bartur në projekte me donatorë, projekt ky që kemi shumë marrëveshje të nënshkruara me partnerë të ndryshëm. Në urbanizëm kanë ngeluar pa u realizuar edhe 30.000euro dhe ne kemi menduar që këto mjete t'i bartin në mallra dhe shërbime. Në arsim e kemi ndërtimin e shkollës në Retijë 31.987euro, ky projekt ka qenë i buxhetuar me kohë, mirëpo vitin e kaluar operatori në fjalë e ka bërë një padi, ose përmes zyrës së thesarit janë tërhequr mjetet dhe pjesa e buxhetuar që e kemi planifikuar në kuadër të këtij projekti ka ngeluar dhe si rezultat i kësaj janë krijuar mundësitë që edhe ky projekt të ridestinohet. Te riparimi në shkolla në komunën e Rahovecit 16.747euro janë mjete të cilat janë ndërprerë kontratat me operatorët për shkak të shumë arsyeve të ndryshme, me çrast këto mjete kanë ngeluar dhe kemi menduar për ri-destinim. Kjo pikë e rendit të ditës duhet të votohet sepse kemi të bëjmë me 175.000euro, mjete të cilat rrezokojnë të shkojnë në suficit.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, anëtarët e kuvendit komunal, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesin e KFOR-it – OSBE-së dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Unë deshta t'ia bëjë disa pyetje drejtorit të financave; Pse p.sh në buxhet të këtij viti janë paraparë këto projekte e tani në fakt duhet t'i ridestinojmë, a mund të them që ky është një keqplanifikim?... Tjetra, nëse unë nuk jam gabim, për buxhetin e vitit 2023 kemi ndarë mjete për disa projekte që tani dëshirojmë t'i ridestinojmë, pse nuk po vazhdohet të punohet në ato projekte p.sh në zonën industriale etj, etj... Ndoshta kur është bërë buxheti është dashur me kohë

të mendohet për këto mjete, e jo tani t'i ndryshojmë projektet. Tjetra, a mund që këtyre mjeteve t'i ndërrohet kategoria ekonomike, nëse kanë qenë mjete për investime kapitale, ndoshta me i dërgu me një kategori tjetër.
**Afrim Limani** – Faleminiderit mësues për pyetjen, konsideroj që është pyetje me vend. Çdo projekt që aktualisht propozohet për ridestinim ka qenë në listën e projekteve kapitale të planifikuara. E thash edhe në fillim që për shumë arsye këto projekte nuk kemi mundur t'i realizojmë dhe secili projekt në vete e ka karakteristikën e vet dhe arsyen që nuk është realizuar. Pas një analize të mirë të bërë nga drejtoria e financave me drejtoritë përkatëse këtë projekte i kemi ridestinuar aty ku është mëse e nevojshme. Me theks të veçantë e bëre pyetjen për zonën ekonomike. Për këtë zonë ka qenë një buxhet i planifikuar prej 60.000euro, ndërsa këtu i kemi ridestinuar 30.000euro sepse kemi arritur me ministrinë e zhvillimit ekonomik një memorandum mirëkuptimi dhe tërë këtë projekt e financon ministria e zhvillimit ekonomik. Duke e parë traditën deri më sot, komunës së Rahovecit nuk i ka shkuar asnjë mjet në suficit, për këtë arsye e kemi lënë edhe sot ridestinimin dhe nuk kemi nevoj t'i rrezikojmë edhe këto projekte të shkojnë në suficit.
**Rasim Fazliu** – Drejtor, te kategoritë ekonomike kemi projekte 80.000euro investime kapitale dhe kalojnë në mallra dhe shërbime, a është e ligjshme kjo?... Përndryshe unë jam për ridestinim dhe mjetet mos të shkojnë huq.
**Afrim Limani** – E thash në fillim që çdo ridestinim i ka arsyet e veta, pyetja jote dhe e shumëkujt mund të jetë pse pikërisht në mallra dhe shërbime? Ne e dijmë që raporti i auditorit për pasqyrat financiare të komunës së Rahovecit ka dalur i keq si rezultat i këtyre keqklasifikimeve, për këtë arsye jemi detyruar që shumë pagesa që kanë qenë të planifikuara në kuadër të investimeve kapitale jemi detyruar t'i paguajmë prej mallrave dhe shërbimeve. Aktualisht janë disa obligime në mallra dhe shërbime, gjithashtu edhe këto projekte e kemi menduar t'i ridestinojmë në mallra dhe shërbime.
**Burim Krasniqi** – Te pyetja e Rasimit, dua të ndërlidhem pak më ndryshe. Këto investime kapitale; Krijimi parkingjeve në qytet, rregullimi i infrastrukturës së stacionit të autobusave, investime në turizëm – shtigjet e ecjes etj… Cila është arsyeja e dështimit të këtyre projekteve? Njëra prej asambleisteve foli direkt për shqetësimet në shtigjet e ecjes, janë projekte që kanë patur mjete tepricë? Apo janë projekte të cilat nuk kanë arritur të tenderohen – zhvillohen. Nuk jam i interesuar të shkojnë në suficit, por jam i interesuar pse ka ndodh kjo situatë.
**Afrim Limani** – Në fillim thash që secili projekt për arsye të ndryshme nuk ka mundur të planifikohet. Pyetja jote ishte për krijimin e parkingjeve të reja në qytet. Për këtë punë më mirë e din drejtori i shërbimeve publike, por jam sqaruar me të dhe arsyeja është për shkak të projektit të sheshit në qendër ...
**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është (për) miratimin e këtij propozimi për bartjen e mjeteve?... kundër?... abstenim?... Atëher me 23 vota për, pa vota kundër dhe me 5 vota abstenim, miratohet ridestinimi i mjeteve financiare nga viti 2022.
**6. Shqyrtimi dhe miratim i vendimit për miratimin e projekt - planit për trashëgimi kulturore 2022-2025;**
**Afrim Dina** - Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit dhe të gjithë të pranishëm. Para juve keni draft propozimin për planin për trashëgimi kulturore në komunën tonë siç po e shihni në projektor. Grupi punues i formuar nga kryetari i komunës me datë 01.08 kanë filluar punimet për planin e trashëgimisë kulturore, gjithashtu janë kryer të gjitha procedurat ligjore për konsultimin publik i cili ka dalur më 18.08 dhe ka përfunduar më 19 shtator. Gjithashtu është mbajtur edhe një konsultim një debat publik me qytetarë këtu në sallën e kuvendit me datë 06 nëntor ku edhe janë marrur propozimet e që më pas janë implementuar në këtë plan. Shfrytëzoj rastin edhe t'i falënderoj për kontributin e tyre të cilët i kanë ndihmuar grupit punues duhe i ndihmuar rreth objekteve të cilat ndoshta nuk kanë qenë të njohura për ne. Poashtu shfrytëzoj rastin ta falënderoj asambleistin z. Eqrem Spahiu i cili për dy ditë rresht në pjesën e Opterushës, Zoqishtit dhe Retijës i ka ndihmuar shumë grupit tonë. Rreth punës të cilën e ka bërë grupi punues në këtë draft; kanë qenë analizat në terren (SWOT analiza) i keni në faqen 12, janë të paraqitura dobësitë që i kemi te objektet apo monumentet kulturore në komunën tonë që kërkojnë mirëmbajtje dhe trajtim. Këtu janë synimet dhe mundësitë që i jep komuna jonë në

gjithë territorin e saj. Materialin iu kemi dërguar, besoj qe e keni analizuar. Qëllimi kryesor i këtij plani 2022-2025 është që t'i ruajmë sa më shumë monumentet ekzistuese, monumentet tjera që duhet t'i gjejmë, një pjesë të madhe e ka gjetur grupi punues. Në shtator çdo vit e bëjmë kërkesën në qendrën rajonale në Prizren që këto monumente t'i fusim në trashëgiminë e mbrojtjes. Materialin e kemi bukur voluminoz, nuk dua të iu marr më tepër kohë, këtu do të jemi për të gjitha, ndoshta kemi harruar diçka por e di që grupi punues ka gjetur disa ura tjera, njëra prej tyre është në Fortesë – Pataqan e cila që ka shumë gurë dhe ka nevojë për funsionalizim.

**Hasan Përboqi** – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për kolegët asambleista në veçanti për drejtorin e DKRS-së për këtë prezantim. Konsideroj që plani për trashëgimi kulturore është një dokument shumë me rëndësi, për arsye që i mbledh të gjitha gjërat lidhur me trashëgimi dhe është një dokument që i ka munguar komunës sonë. Konsideroj që një turist kur të vie në Rahovec të paktën e ka një dokument që i ka të përmbledhura të gjitha pasuritë e trashëgimisë kulturore - natyrore apo edhe asaj mikse që i posedon komuna jonë. Dokumenti është voluminoz. Sa kam arritur ta lexoj i ka të përmbledhura shumicën e atyre aseteve të komunës dhe qytetit. Ndoshta është i përmendur diku, por nuk më ra në sy; është një epigraf që gjendjet në Teqen e Madhe këtu qytet, pllakë e madhe e gurit që e ka të vizatuar kalaveshin e rrushit. Nuk po e shoh që është i përmendur askund dhe duhet ta dijmë që vlera e këtij objekti është shumë e madhe sepse brenda vetës e prezanton një histori të madhe të rrushit që komuna jonë mburret. Aty prezantohet që treva jonë merret me rrush qysh nga koha romake dhe nëse nuk është ky objekt te këto tabelarë, ta jep përshtypjen që nuk është i përfshirë në këtë plan.

**Afrim Dina** – Faleminderit z. Përboqi, ndoshta ka lëshim teknik që nuk është përfshirë këtu ajo, por jam i sigurtë që është, sepse vet kam qenë pjesë e planit dhe patjetër që do të jetë.

**Sejfullah Sejfullahu** – Faleminderit drejtor për informatën. Ne do të kishim pas dëshirë ta qesim "Bunarin e Nezës" që ka histori mbi 200vjeqare, por në atë kohë serbët lokal e kanë mbuluar atë vend. Një pyetje tjetër sa i trashëgimisë kulturore te kufijve administrative të komunave, e kemi pas një "zatop" që pijshim ujë edhe Krusha e Madhe edhe Krusha e Vogël aty në "mexhe", kush duhet ta rregulloj aty Prizreni apo Rahoveci?... Më pastaj e kam edhe një kërkesë.

**Afrim Dina** – Faleminderit Sefë. Grupi punues kur ka qenë në Krushë të Madhe, njëri prej anëtarëve të grupit punues është edhe Irfan Ramadani. Në takimet që i kanë mbajtur atje ose kontaktet me banorë duke filluar me Fatmir Sejgullahun dhe shum të tjerë dhe është konstatur që do të dalim ta shohim bunarin dhe nëse prej kufijve administrativ në çoftëse gjysa është nga ana jonë duhet ta rregullojmë ne, nëse jo atëherë qendra rajonale e Prizrenit ka përgjegjësi.

**Merisa Sharku** – Po lidhna pak me Hasanin, është shumë mirë që është bërë një draft i tillë sepse Rahoveci është një ndër qytetet më të vjetër të Kosovës dhe ka shumë trashëgimi kultuore dhe asnjëherë nuk e ka patur një përmbledhje të tillë. Mungesa ka, nuk është i përpiluar në mënyrë shumë profesionale. E vërejta listën e emrave se kush ka qenë pjesë e grupit punues, prap aty nuk pash që ka qenë dikush prej ekspertëve, shumica janë që punojnë në komunë. Grupi punues ose duhet të zgjerohet me ekspertë të fushës ose të zëvendësohet me këta persona. Këtu kisha patur lutje që tani e tutje të vazhdojmë ta ruajmë, po lidhna me pjesën e kaluar që është shkatërruar shumë dhe jo të ekzistojë në mendësinë tonë që një objekt të rinovohet. Te restaurohet, të konservohet dhe të ruhet.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, i nderuar drejtor. Është mëse i nevojshëm një plan i tillë për trashëgiminë kulturore për komunën e Rahovecit. Komuna jonë ka një trashëgimi ndër shekuj, shumë mire që drejtori e ka formuar grupin punues, siç e tha edhe kolegia parafolëse ka disa mangësi, por meqenëse është dokument që plotësohet vazhdimisht, ndryshim - plotësimet i bëjmë ndërkohë dhe si grup i asambleistave e përkrahim.

**Drilon Mustafa** – Përshëndetje, e përgëzoj drejtorin për punën e bërë. Materialin e kam lexuar dhe e kam vërejtur që nga fshati Guri i Kuq nuk është asnjë objekt d.m.th në bazë të fotove Guri i Kuq nuk është përfshirë!

**Afrim Dina** – Derisa Skenderi e kërkon në monitor, faleminderit shumë për kontributin. Rreth pjesës së anëtarëve të grupit punues i kemi kontaktuar edhe 4 qytetarë tjerë që janë të fushës, mirëpo për shkak të angazhimeve që i kanë ata, janë përgjigjur me falënderime po që nuk mund të marrin pjesë dhe n'a është dashur ta marrim barrën përsipër dhe të dalim vet në terren. Te Driloni, është Guri i Kuq dhe sipas të dhënave ne e kemi vendosun në planin e trashëgimisë.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë. Pa humbur kohë ne po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë unanime miratohet vendimi për projektin e planit të trashëgimisë kulturore 2022-2025. Atëherë çdo herë e kam ditur që Krusha e ka zemrën e gjërë, këtë po na dëshmon edhe Sefa sot, i cili për kohën e pauzës na ka nderuar duke na përgatitur dy fli.

**Sejfullah Sejfullahu** – Kjo është sa i përket planifikimit se kur do të bëhet "Agro-Festa" dhe kur jemi te trashëgimia e vjetër; Bukë e krip e zemër.

**Kryesuesi** – Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, të gjithë të pranishëm. Po fillojmë pjesën e mbetur të seancës. Falenderojmë për drekën z. Sejfullah Sejfullahu dhe zonjën e Sefës, Bukurijen.

**7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2023;**

**Afrim Limani** – Përshëndetje. Sipas ligjit 06/ L-005 mbi tatimin në pronën e lejueshme, të gjitha kuvendet komunale janë të detyruara që ta votojnë normën tatimore. Sa për informimin tuaj kufijtë minimal dhe maksimal të normave tatimore janë nga 0.16% deri në 1%. Në nivel të republikës së Kosovës, komuna jonë i ka normat më të ulëta.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues. E falënderoj drejtorit dhe desha ta pyes a ka ndryshime të normave tatimore që janë deri tash, cili është ndryshimi, po të ishte një tabelë këtu ndoshta nuk do ta kisha bërë këtë pyetje. Pra, a ka ndonjë ndryshim të normave tatimore karshi normave që kanë qenë.

**Afrim Limani** – Faleminderit mësues për pyetjen. Ndryshim në norma tatimore nuk ka që nga viti 2018, janë të njëjtat norma tatimore, mirëpo janë shtuar parcelat dhe njësitë pyjore të parcelave.

**Kryesuesi** - Faleminderit drejtor. Dikush tjetër ndonjë gjë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e kësaj pike?... Me shumicë unanime miratohet edhe vendimi për caktimin e normave tatimore.

**8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave 2022-2027;**

**Mirsad Shala** – Faleminderit kryesues, i nderuari nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit. Me datë 23.09.2022 kuvend i komunës ka marrë vendim për miratimin e planit për menaxhimin e mbeturinave, mirëpo nga ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kemi pranuar një shkresë në të cilën na kanë udhëzuar që në titullin e këtij plani që ka qenë më herët 2022-2026 është dashur të jetë 2022-2027, kështu që nuk ka ndyshime tjera përpos vitit, plani për menaxhimin e mbeturinave është 5 vite dhe jo 4. Gjithashtu edhe pika pasuese sa i përket planit tre vjeçar për banim e ka të njëjtin udhëzim, d.m.th grupet punuese kanë bërë gabim në përllogaritjen e viteve, çdo gjë tjetër është në rregull. Ne e kemi parë të arsyeshme të mos bëjmë plotësim – ndryshim, por e kemi shfuqizuar vendimin e mëparshëm për të hyrë në fuqi ky vendim i ri.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues. Është bërë si traditë kopjimi i dokumenteve prej komunës në komunë. Në çoftë ky është plani për miratimin e menaxhimit të mbeturinave për komunën e Rahovecit, këtu në këtë plan nuk janë të shkuara as faqet që të jemi në dijeni se në cilën faqe jemi duke shfletuar, por në fletën e dytë shkruan kështu: Ministria e Mjedisit - Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, për ndryshimit dhe plotësimin e rregullores... kërkon nga kuvendi i komunës së Prishtinës, deshta të pyes; ne a jemi komuna e Rahovecit a e Prishtinës, në çoftëse është gabim teknik duhet përmirësuar dhe të shkruhet drejtë. Tjetër; është e vertetë që këtë rregullore e kemi kaluar një herë, por për shkak të arsyes së lartëcekur për

shkak të afatit 5 vjeqar e ka rikthyer MAPL-ja. Aq sa unë e kam lexuar brenda aty, deponia rajonale në Landovicë ka patur afar deri në vitin 2020, më pas është shtyrë deri 2025, meqenëse ky plan ka afat deri më 2027, shtrohet pyetja e keni menduar ku do të bohet deponia rajonale në ato vitet pas 2025, ku i dërgojmë mbeturinat dhe a është i paraparë vendi deri në 2027.

**Mirsad Shala** – Kërkoj falje që nuk e përmenda në fillim që në mungesë të drejtorit, unë kam dalur t'i mbroj këto dy pika në fakt t'i prezantoj. Pikën e pare që e ceku baca Rasim është gabim i ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor, ndërsa te pika e dytë drejtorit duhet me ia dërgu pyetjen sepse unë jam vetëm prej prezantimin e pikave.

**Kryesuesi** – Faleminderit. Dikush tjetër diçka?... Atëherë po e vendosim në votim pikën e 8-të të rendit të ditës. Kush është për?... Me shumicë unanime miratohet edhe vendimi për miratimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave.

**9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e programit komunal tre vjeçar për banim 2022 – 2025;**

**Kryesuesi** – Pikën e 9-të po e vendosim në votim menjëherë sepse zyrtari ligjor e dha sqarimin edhe për këtë pikë duke thënë që gabimi ka qenë i njëjti te përllogaritja e viteve. Por nëse dikush dëshiron ta marr fjalën?...

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë. Po shihet që shumicën e vendimeve MAPL-ja është duke i kthyer, kërkoj që drejtori ose zyra ligjore më konkretisht në përpilimin e këtyre akteve të jenë më serioz ose më të përpikt që vendimet e dala nga kuvendi mos të na kthehen, sepse 2-3 herë po na bie të votojmë për një pikë të rendit të ditës. Dukumentet që i bie drejtori duhet të jenë me efektivitet të mirëfillt.

**Mirsad Shala** – I nderuar, e ceka edhe më herët që nuk ka qenë gabimi te përpilimi i vendimit nga zyra ligjore, mirëpo gabimin e ka bërë grupi punues dhe drejtoria që nuk e ka bërë mire përllogaritjen e viteve. Nuk ka të bëjë asgjë me përpilimin e akteve.

**Kryesuesi** – Faleminderit Mirsad, edhe pse replika ishte me vend, zyra ligjore të jetë më e vemendshme. Atëherë po e vendosim në votim pikën e 9-të, kush është për?... Me shumicë unanime miratohet edhe vendimi për miratimin e planit komunal tre vjeçar për banim.

**10. Shqyrtimi i raportit financiare për periudhën janar – shtator 2022;**

**Afrim Limani** – Përshëndetje edhe një herë, raporti financiar 9 mujor është i përbërë nga 3 pjesë; Pjesa e analizimit të të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit si dhe pjesa e zhvillimit të kontratave në kuadër të zyrës së prokurimit. Çdo ngjarje mbrenda këtyre muajve janë të përfshira në kuadër të këtij raporti. Të hyrat deri në këtë periudhë në total janë; 929.072euro, nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njejtë me vitin e kaluar, kemi një rritje prej 5681euro. Muaji shtator ka qenë një ndër muajt më të varfër sa i përket inkasimit rë të hyrave sepse ka reflektuar greva e mbajtur nga sindikata e shërbyesve civil. Ju rikujtoj që ende nuk e kemi raportin 3 mujor nga gjobat e gjykatave të trafikut, për këtë arsye e kemi një ndryshim negativ apo një zvogëlim prej 64.000euro që në këtë rast i kemi 1.1 milion bashkë me 3 mujorin e parë të këtij viti inkasim të të hyrave. Konsideroj që raporti do të na vjen shumë shpejtë dhe nëse bëjmë një krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi një rritje të të hyrave. Te shpenzimi i buxhetit; në total është 11.111.779euro ose 67.65%. Mallra dhe shërbime 70.30%, komunalitë 79%, subvencionet 80.53%, shpenzimet kapitale 71.06%, pagat 63.76% dhe në fund e kemi raportin nga zyra e prokurimit me të gjitha ngjarjet apo kontratat të cilat janë kontraktuar nga janari deri në shtator të këtij viti.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Drejtor, të falenderoj për paraqitjen goxha të gjërë të paraqitjes së raportit të shpenzimeve. Te tabela 1.2 faqe 3 te të hyrat duhet me qenë ndonjë gabim teknik sepse kur e bëjmë në përqindje, përqinjda e realizimit të vitit 2022 në muajin mars nuk është 6.48% por duhet të jetë më e madhe, është gabim teknik. Te muaji qershor është 6.6%, te korriku 2.55% totali 8.20% d.m.th kur kolonën 3 me kolonën 2 e

kthejmë në përqindje atëherë kjo duhet të jetë më e madhe dhe jo me qenë vetë 6% dhe besoj që duhet të përmirësohet te raporti final. Tek të hyrat te faqe 6, tabela 1.6 kodet 50,40,9 participimet në arsim, të hyrat 22. 815.50 euro çka participohet në arsim dhe si realizohen këto të hyra këtu?... Te tabela 3.1 faqe 8 te shpenzimet sipas programeve zyra e kryetarit deri më tani ka dhënë 117.530 euro subvencione, çka përfshihet? Sepse është shifër shumë e madhe prej zyrës së kryetarit. Te tabela 3.2 faqe 9, te shpenzimet kapitale janë 4.237.584 prej alokimit prej 5.67milion, që në një formë edhe 1.440.000 euro janë të mbetura për periudhën tetor - dhjetor. A është kjo që kryesisht janë paguar borgje të punëve të kryera të viteve paraprake sepse nuk besoj që kemi arritur të tenderohen dhe të kryhen procedurat e vitit 2022 që të shpenzohet në shtator 74% e buxhetit për investime kapitale, a nënkupton kjo që borgjet e viteteve paraprake janë paguar në këtë periudhë kohore? Shpenzimet e avokaturës të shpendara nëpër drejtori te tabela 3.3 janë; Te zyra e kryetarit dhe drejtoria për buxhet dhe financa janë 21.875 euro në 2022 për dallim nga ajo që në vitin 2021 kanë qenë vetëm 1440euro për këtë periudhë kohore. Në vitin 2021 nuk e keni patur asnjë gjobë të gjykatave, në 2022 në këto sektorë janë 9405euro gjoba. Janë rritur shpenzimet e avokaturës rreth 1000% dhe në anën tjetër janë rritur gjithashtu edhe shpenzimet e gjobave të gjykatës, kjo i bie që nuk ka patur efekt avokatura e kontraktuar nga ana e komunës. Te drejtoria e shërbimeve publike, zjarrfikësat, zyra për komunitete, bujqësia, ekonomia dhe kadastra, prap janë 3161euro pagesa të avokaturës dhe 17.948 euro gjoba të gjykatava dhe përsëri trend negative në raport me vitin 2021 që kanë qenë vetëm 150 euro. Gjobat e gjykatave komplet janë 31.148 euro edhe pse pagesa të avokaturës në 2022 janë rreth 28.240 euro. A është shqetësuese pse paguhet zyra e avokaturës kaq e në anën tjetër të rriten gjobat që vijnë nga gjytata. Më mirë do të na mbronte një zyrtar komunal – jurist sesa një zyrë e avokaturës me kaq pagesa. Drejtor, keni shumë kontrata për konsulent individual, disa mund të jenë të arsyeshëm por, konsulent për pranim të aplikacioneve për fermer me kontratë për dy vite është shumë e gjatë. Te pjesa lott.11 dhe lott.12 konsulent individual arkitekt dhe nuk jepet periudha kohore prej kur deri kur dhe për të gjithë këta njerëz konsulent që vlerësohet që janë të fushës paga mujore e tyre është vetëm 360euro, nëse ka arkitekt që vie për 360euro për mua është befasuese edhe pse për të mire në kuptimin e komunës por nuk besoj që ekziston në realitet. Te tenderi mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes Dejnë – Krushë e Madhe – Dradish – Drenoc – Rahovec, mjetet e alokuara janë 42.323euro e kompania e kontraktuar është 25.481 euro 50% më lirë se planifikimi, a duhet të jetë operatori i papërgjegjshëm apo është bërë një huqje në planifikim zyrtarët e komunës. Ofrimi shërbimeve juridike – lirgjore për nevoja të komunës, ritenderim 2022-2024 është planifikuar 124.000euro, ka konkuruar fiks me 124.000euro dhe e ka fituar. Rasti tjetër; Ruajtja dhe trajtimi i vlerave të trashëgimisë kulturore - krijimi i sigurisë të levizjes së qytetarëve, planifikimi është 174.519euro, kontrata është 174.500euro me diferencë 19euro, d.m.th shumë i përputhur planifikimi me përfituesin dhe është pak shqetësuese. Te pjesa tjetër; Ndërtimi i depos bujqësore këtu është vetëm alokimi, vlera e kontratës nuk është e cekur, 499.169euro. Shpresoj që nuk e kam tepruar dhe e gjej mirëkuptimin e juaj në këtë drejtim.

**Leonard Morina –** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Drejtor, unë e pata një pyetje te tabela 2.1 te shpërndarja e faturave - regjistrimi dhe verifikimi të objekteve në tatim në prone. Në vitin 2021 numri faturave të shpërndara është më i madh sesa në vitin 2022 për 816 fatura më pak. Numri i objekteve është për 158 objekte më shumë apo 28.000 metra katror d.m.th sipërfaqe ka më shumë, fatura të shpërndara ka më pak, pse në vitin 2022 ka ndodh shpërndrja më e vogël e faturave kur dihet që objekte dhe sipërfaqe për metër katror kemi më shumë.

**Afrim Limani –** Burim, keni bërë shumë pyetje, nëse nuk mundem të përgjigjem në të gjitha mund ta bëjmë bisedën interaktive. Te faqja 3, gabimi në përqindje; të them të drejtën as unë as punëtorët e mi nuk e vërejmë këtë sepse vetëm sipas formulës del ai rezultat automatikisht, sido që të jetë faleminderit. Te participimi në arsim; Si kod ekziston dhe duhet të ekzistoj sepse është rregull financiar dhe që realisht deri më tani nuk kemi patur të hyra. P.sh dikush bënë kërkesë ta vazhdoj arsimin joformal pas orarit të punës si në arsimin fillor dhe të mesëm

edhe pse deri më tani nuk kemi patur kërkesa përveç njërës. Ndërsa 22.815 janë të hyrat nga qerdhja e fëmijëve, participimi në kuadër të qerdhes së fëmijëve. Pyetje tjetër ishte; Zyra e kryetarit ka bërë shpenzime në subvencione në vlerë prej 117.530. Këtu 64.000euro janë bursa për student, përafërsisht 30.000euro janë shpenzime që kryetari i përgjigjet qytetarëve në bazë të kërkesave shëndetësore për sëmundje të ndryshme. Shpenzimet kapitale, 4.237.000 kanë ngelur, mos të harrojmë që raporti është i përgatitur deri më 30 shtator, deri më këtë datë shpenzimi i buxhetit për investime kapitale ka shkuar 75% dhe ju garantoj që deri në fund të vitit do të hargjohet deri në 98%. Te shpenzimet e avokaturës; Eshtë e verëtetë që e kemi një kontratë për shërbimet të avokaturës dhe vlera e shpenzimit deri tani është 24.000euro dhe në cilësinë e drejtorit më ka interesuar edhe mua por një ankesë për ta bërë kishte goxha një kosto dhe të gjitha këto ndodhin për shkak të numrit të madh të padive që na bëjnë mësuesit është arritur kjo vlerë. Besoj që vitin e ardhshëm dukshëm do të bie kjo vlerë sepse kemi shumë ankesa dhe padi nga ana e mësimdhënëse sa i përket kontratës për shujta. Pyetja tjetër ishte rreth shërbimeve konsulente, pse kaq shumë konsulentë. Në kontratë shkruan që kompania kontraktuese të gjithë fermerëve iu ka pergatitur edhe projektin për aplikim të cilët kanë një kosto. Kemi konsulentë që kemi patur nevojë për ta, sipas ligjit në fuqi e kemi hapur këtë tender, kanë aplikuar njerëzit që realisht kanë nevojë për punë. P.sh për drejtorinë time kam nevojë shumë për punëtorë sepse kam staf të reduktuar, tani janë punësuar njerëzit dhe punët po ecin mirë si me regjistrim njejtë edhe me inkasim. Te kontratat që the për vlerën e parashikuar që është lidhur me një ndryshim shumë të vogël të mjeteve, janë ligjet në fuqi nuk e di pse, çdo gjë ka shkuar përmes zyrës së prokurimit e cila është shumë e monitoruar nga çdo kush.

**Sinan Kryeziu** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit që janë në sallë. Unë dua të ndërlidhem me drejtorin për punën e shpenzimeve të avokatit. Sdi sa e kujtoni ju, unë pata ngritur si shqetësim në momentin që është lidhur kontrata mes komunës dhe avokatit, dhe për shkak që jam jurist e kam paraparë që do të ndodhin këto pasoja buxhetori në dëm të qytetarëve dhe taksave të tyre. E kapa për fjale drejtorin kur tha që kemi kontratë të jurispodencës, tani drejtori këtu me dashje ose pa dashje na lë të kuptojmë që avokati duhet të jetë me jurispodencë i regjistruar e licencuar në odën e avokatëve të Kosovës. Te çështjet civile jam munduar në formën time ta ngrisë këtë shqetësim dhe ta ndalim këtë kontratë të dëmshme. Drejtori tha që për momentin janë dhënë 24.000euro. Këta detyrohet që 50.000euro me ia dhënë avokatit për përfaqësim. Nuk është problem që komuna dëmtohet me 50.000euro, këta e dëmtojnë edhe në procedura gjyqësore. Pata thënë disa here duke e përsëritur, këta i kanë kontestet e humbura. Mendoj që te çështjet civile nuk duhet te jetë patjetër avokat i regjistruar në odën e avokatëve të Kosovës, te çështjet civile mund ta përfaqësoj çdo jurist. Këta i kanë 5 jurista, duhet sa më parë ta shkëpusin këtë kontratë duke ia kërkuar rezultatet pozitive avokatit në fjalë, avokati paguhet për kryerjen e shërbimeve në interest në komunës jo vetëm të gjepit të vet personal. Për këtë çështje do të ballafaqohem me kryetarin. Për një padi, juristi paguhet sipas vlerës së kontestit dhe kjo është e rregulluar me ligj. Nuk është në pyetje që do ta paguajmë avokatin 50.000euro, këtu do të paguhen shpenzimet gjyqësore si dhe avokatin që ka parashtruar padi në fund ndaj në këtë rast paditësit. Sinqerisht është shqetësuese, me informacionet që i kam unë, këta i kanë rreth 800 padia të parashtruara, janë shifra të mëdha dhe në fund viktimizohen duke thënë që nuk është problem jonë por i shtetit që nuk e ka rregulluar këtë me ligj. Juristat munden, kam propozuar me hy në marrëveshje me paditësat, tërhiqe padinë si e përcakton ligji dhe ne bëjmë marrëveshje, sa i pëket parave e bëjmë me rata sepse të gjithë jemi njerëz duhet ta gjejmë një mes që t'i ikim shpenzimeve. Këta do t'i humbin të gjitha paratë. Faleminderit.

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues. Për drejtorin e financave i kam dy pyetje rreth këtij raporti financiar. Të hyrat komunale, veçanërisht ty hyrat që rrjedhin si obligime të rentes dhe qirasë komunale sa janë realizuar?... E dyta; Çfarë veprime juridike ka ndërmarrë komuna në drejtim të realizimit të të hyrave komunale, kur dihet se nga kalimi i afateve ligjore komunës i shkaktohet dëme.

Afrim Limani – Nëse jeni të interesuar për kurreshjte të të gjithëve, unë mund ta thërras edhe avokatin këtu që ai tjep një raport më të detajizuar para juve. Leonardi pyeti rreth dallimi të faturave në 2021 janë 13.320, ndërsa në vitin 2022 janë më pak, arsyeja është sepse në këtë vit e kemi bërë një veprim shumë duhur duke e bërë ronifikimin e tatimpaguesve. Kemi arritur që në kuadër të një tatimpaguesi (një letërnjoftimi) të bëjmë bashkimin e të gjitha atyre pronave që është pronar personi fizik dhe për këtë arsye ka ardhur deri te ky zvogëlim. Lirigzoni, te të hyrat nga qiraja; Te kodi 50407 të planifkuara janë 80.000, ndërsa të realizuar janë 56. 530 euro. Në periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi dallim 24.000euro që i bie inkasimi në qira të jetë mjaftë i mire. Pyetja tjetër lidhun me marrjen e ndonjë veprimi për mospagesën e llogarive të arkëtueshme, të them të drejtën drejtoria për ekonomi ka marrur disa veprime si taksa afariste si dhe në qira sipas kontratës. Tatimi në pronë është një problem më i madh me shumë borgje, janë duke u rregulluar disa procedura ligjore dhe me "kismet" vitin tjetër mars – prill duhet të dëergohen te përmbaruesit.

**11. Informatë për përgatitjen e vitit shkollor nga DKA-ja 2022/2023;**

**Avni Morina** - I nderuar kryesues, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, të nderuar drejtorë. Këtë informatë e keni në e-mailat e juaj të shpëndarë nga sekretaria e kuvendit. Aty jemi munduar të pasqyrojmë fillimit e aktivitetit që e kemi ndërmarrur për fillimin e vitit të ri shkollor 2022-2023. I kam pasqyruar të gjitha aktivitetet e muajit të fundit dhe fillimit që parashihet në shtator. E para është plotësim i informatës, e dyta është një pyetje që e ka bërë asambleistja Besa Bytyqi në KPF. Në kohën kur është bërë informata kam thënë që së shpejti do të bëhet furnizimi me lendë ngohëse në shkolla, ndërsa në këtë informatë ky proces gati është në përfundi, kanë mbetur edhe dy shkolla për furnizim. Te përgjigja për orarin e punës për edukatoret e fëmijëve në qerdhe; Bazuar në udhëzim administrativ qerdhja hapet në 7:30, puna fillon në 08:00 – 16:00, mirëpo nuk mbyllet deri në 16:15.

**Fahrije Lushi** – I nderuar kryesues, nënkryetar, drejtorë dhe kolegë këshilltarë. Meqë drejtori sot ishte më i shkurtë dhe i prezantoj shumë mirë dy pikat më kryesore dhe meqë ne jemi pjesë e komitetit për arsim kemi mbledhur të dhëna të ndryshme nga shkollat të ndryshme në qytet dhe fshatra. Më intereson nga drejtori informacioni se sa po respektohet lista e pritjes sepse ka mjaftë ankesa nga kandidatë të ndryshëm. Pastaj është edhe një shqetësim tjetër sesa po realizohen zëvendësimet të shtunave, a keni biseduar me drejtoritë e shkollave dhe këshillin e prindërve dhe ku është problemi që nuk realizohen zëvendësimet të shtunave.

**Leonard Morina** – Faleminderit. Pasiqë edhe unë jam në komitetin për arsim, shumica e shkollave janë të furnizuara me dru dhe deshta ta bëjë një krahasim. Në vitin e kaluar një metër dru ka kushtuar 48euro, kurse në këtë vit është nënshkruar kontrata prej komunës me 83euro për metër kub. Nëse shkollat e kanë patur buxhetin 10.000euro dhe 5000euro zakonikisht shkojnë për dru. Shkolla e Malësisë së Vogël per 150metra ka paguar 6750euro tani për 150metra duhet të paguhen 12.450euro d.m.th 90% e buxhetit të shkollës hargjohet për dru, a ka paraparë drejtori ndonjë buxhet shtesë, a ka kërkuar mjete prej drejtorive përkatëse ose si do të bohet zgjidhja deri në përfundim?...

**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesues. E lexova informatën që drejtori e ka prezantuar. Më intereson një pyetje për drejtorin. Zvogëlimi i numrit të nxënësve ka shkaktuar probleme dhe ka ndikuar edhe në zvogëlimin e numrit të klasave, sa ka qenë numri i të regjistruarve për herë të parë vitin e kaluar në komunën tonë dhe sa është tani?...

**Avni Morina** – Falenderoj të gjithëve për kontributin. Zonja Fahrije Lushi; Sa po respektohet lista e pritjes së kandidatëve?... Gjatë këtij viti shkollor kemi patur konkurse në fillim të vitit dhe sipas nevojës. P.sh për programin fillorë dhe parafillorë nuk e kemi patur problem sepse e kemi hapur konkursin në muajin shkurt, procedurat e konkursit janë zhvilluar rreth 1.5 muaj sipas ligjit. Në këtë program i kemi ftuar kandidatët nga lista e pritjes me radhë. Viti i ri shkollor nuk filloi me kohë, për shkak të grevës dhe viteve të kaluara për shkak të pandemisë por ju garantoj që lista e pritjes po respektohet në mënyrë të vazhdueshme sepse nuk guxojmë ta kalojmë radhën e atyre kandidatëve që janë kualifikuar sipas konkursit. Zëvendësimi i të shtuneve nuk po bohet

për arsye se ende nuk kemi marrëveshje në mes ministrisë së arsimit dhe sindikatës. Ne si DKA nuk kemi të drejtë t'i obligojmë mësimdhënësit të mbajnë mësim sepse nuk e kemi bërë grevën dhe nuk mund ta mbyllim. Si DKA kemi propozuar që gjatë ditëve të punës të bëhet zëvendësimi me nga një orë sepse 185 ditë mësimi i ka viti shkollor, mirëpo kjo ide nuk është përkrahur dhe në fund kemi mbetur pa marrëveshje. Te kontrata për lëndë grohëse (dru dhe pelet), drejtoria e arsimit bashkë me drejtorinë e financave jemi kujdesur ta bëjmë mbulimin buxhetor të kontratës së re që e kemi lidhur sepse ne e kemi patur një kontratë 3 vite mirëpo për shkak të ankesave të mëdha të operatorit jemi detytuar ta shkëpusim atë kontratë, kemi lidhur kontratë të re sipas çmimeve të tregut me 83 euro për metër kub, peleti 650 një ton. Do të mundohemi që t'i mbulojmë kërkesat e shkollave dhe e kemi bërë një plan të shpërndarjes. Është formuar një komision i cili do të bëjë kontrollin e shpenzimit dhe furnizimit duke i raportuar kryetarit të komunës çdo dy javë. Lirigzon, zvogëlimi i numrit të nxënësve është vërtetë shqetësues sepse çdo vit rreth 300/400 fëmijë më pak i kemi nëpër shkollat tona dhe është vërtetë dukuri shqetësuese. Sivjet në bazë të dhënave zyrtare që i kemi regjistruar së fundmi janë 400 nxënës më pak sesa vitin e kaluar, prej klasave parashkollore deri te klasa 12, d.m.th ky është totali prej të gjitha paraleleve, vitin e kaluar ka qenë 9000 nxënës sivjet është 8600. Është dukuri shumë shqetësuese sepse kur zvogëlohet numri i nxënësve, zvogëlohet edhe numri i klasave dhe rrjedhimisht zvogëlohet edhe fondi i orëve të cilat duhet t'i mbajë mësimdhënësi.

**Fahrije Lushi** – Me shumë kënaqësi e marr këtë përgjigje të drejtorit që po respektohet lista e pritjes, mirëpo çka nëse ka ankesa që ekzistojnë dhe figurojnë që është shkelur lista? Nuk jam këtu t'i them emrat, por ka ankesa dhe kam informata sidomos te cikli parashkollor është "kapërcy" pak.

**Vlora Vuçiterna** – Një pyetje të shkurtë për drejtorin e arsimit. A dihet saktë se kur do të përfundojnë punimet në shkollën "Isa Boletini" meqenëse fëmijët që vijojnë mësimet në parashkollor janë të detyruar që rreth 40 nxënës t'i vijojnë mësimin bashkë në një klasë.

**Avni Morina** – Së fundi e pata një rast te lënda e gjuhës angleze dhe personin që ishte në listën e pritjes zyrtarisht e ftova në DKA dhe i thash që je në listën e pritjes, janë 12 orë të lira në fshatin Pastasel dhe Kaznik. Keni të drejtë të shkoni në zëvendësim për 6 muaj minimum sepse lehona mund të merr pushim deri në një vit. Tha jo, nuk jam i interesuar. Atëherë jam detyruar ta thërras tjetrin pas tij dhe kjo nuk është shkelje sepse unë duhet të bëjë zgjidhje. Zyrtarisht deri në këtë moment që po flasim nuk kemi asnjë ankesë për listën e pritjes. Vlora faleminderit, pyetje me vend. Dje kam vizituar shkollën "Isa Boletini" kemi biseduar për çështjen e kthimit të fëmijëve nga shkolla " Sadedin Hajda" që janë përkohsisht atje. Punimet në shkollën "Isa Boletini" ndonëse gati kanë përfunduar, kanë mbetur edhe dy pompa të kalldajës të montohen për ta bërë funksionale ngrohjen qëndrore. Sa për informacionin tuaj, ne para 10 dite bashkë me kryetarin i kemi dërguar një shkresë zyrtare fondit të Kosovës për efiçiencë të energjisë duke iu kërkuar që sa më parë të përfundojnë punimet e efiçiencës në shkollën "Isa Boletini", në "Bekim Sylka, në "12 Maji", në "Skender Kastrati" paralelja në Gexhë e cila ka një kulm në gjendje të mjerueshme. Kjo është përgjigja adekuata dhe në çoftëse nuk ndodh riparimi i atyre pompave të kalldajës apo pompave termike, unë bashkë me juve do të protestojmë.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor. E kemi një informatë; Prej sekretarisë së kuvendit nëpër emailat tuaj e keni një kërkesë të bashkangjitur me një link, kërkohet të plotësohet nga ju, linku ka të bëjë për çmimin e ekselencës komunale. Ky pyetësor synon ta vlerësoj punën e komunës sonë dhe 12 komunave tjera që bëjnë pjesë në këtë garë. Po ju lutem që ta plotësoni dhe t'i kushtoni vëmendje. Një informatë tjetër; Është një aktivitet "Muzet e Alpeve" për më gjerësisht e paraqet drejtori.

**Afrim Dina** – Faleminderit kryesues. Nesër në ora 13:00 në sallën e kuvendit është një aktivitet që duhet "Muzet e Alpeve" nga shoqata "Teuta" që është nga pjesa e Malit të Zi. Do të vijnë shumë letrarë, iu kemi shpërndarë dhe e kemi publikuar nëpër rrjete sociale. Ju ftoj të merrni pjesë nesër prej orës 13:00.

**Merisa Sharku** – Pyetja është për drejtorin e DKA-së, më herët është fituar një grant prej ministrisë për shkollën në Pastasel, kur do të fillojnë punimet po pyesin banorët e Pastaselit?...

**Avni Morina** – Shkolla në Pastasel dhe qerdhja në qytet kanë qenë projekte të miratuara dhe buxhetuara nga niveli qëndror dhe asnjëri prej këtyre projekteve nuk ka marrur dritë të gjelbërt për të filluar. Nga DKA është kërkuar shumë më herët që t'iu ofrojmë situacionin e terrenit, kopjen e planit, dokumentet e parcelës etj... Por fatkeqësisht edhe pse kanë qenë të buxhetuara 100.000euro për shkollën në Pastasel dhe 60.000 euro për qerdhen e re në qytet në legjen epërme asnjëri prej këtyre dy projekteve deri në kohën kur po flasim nuk ka filluar. Ndoshta mund të filloj projekti gjatë këtyre ditëve, në anën tjetër shpresoj që mos ta hudhin poshtë ose të paktën të planifikohet të fillohet vitin e ardhshëm.

**12. Shqyrtimi i raportit të performancës komunale për vitin 2021;**

**Nënkryetari** – Faleminderit kryesues. Në mungesë të Biondinës si koordinatore për performancë lokale, po e prezantoj shkurtimisht. Ky raport përmban 19 fusha të raportimit me gjithsej 109 tregues, raporti i performancës është për vitin 2021. Për secilën fushë i keni shënimet në detaje në bazë të përqindjes. Për dallim prej vitit të kaluar, monitorimi është shumë më i madh prej ministrisë përkatëse.

**Burim Krasniqi** – Nënkryetar, unë u mundova ta lexoj raportin, realisht e kam shfletuar komplet. A është raport mbi bazën e të cilit del performanca e komunës së Rahovecit në të ardhmen në vitin 2021, apo është raport i performancës së komunës sepse këtu flitet për të gjitha komunat e Kosovës. Ne jemi duke e diskutuar një raport që më shumë ma lë përshtypjen e ministrisë të Pushtetit Lokal sesa raport i performancës. Nuk ka asgjë për komunën e Rahovecit, nuk është asnjë rresht. Këtu flitet për komunat e Kosovës.

**Nënkryetari** – Në pjesën e parë është e vertetë ajo që thotë Burimi, ndërsa në pjesën tjetër tek përmbajta te fushat e raportimit edhe te treguesit tregojnë performancën. Është obligim ligjor që ky raport të kalohet përmes kuvendit, asgjë më tepër. Për fushat e raportimit është një grup punues, e kemi Skenderin këtu në mungesë të koordinatores mund t'ju jap informata më tepër.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues. Desha të ndalem te fushat, mesiguri është ndonjë lëshim. Këtu shkruan fusha 16 – (Përfaqësimi gjinor), pastaj në faqen tjetër e kemi përsëri fusha 16 – (Arsimi parauniversitar). Dy fusha me të njëjtin numër.

**Burim Krasniqi** – Meqenëse Skenderi qenka pjesë e grupit punues, a mund ta shpjegoj se a është dokument mbi bazën e të cilit bëhet matja e performancës të komunave, në këtë rast komunës së Rahovecit që i vie dikur më vonë raporti i performancës apo çka është? Sepse kjo është e përgjitshme dhe flet për të gjitha komunat e Kosovës.

**Skender Hamza** – Atëherë përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Burim, ky raport është raport i performancës komunale për vitin 2021. Është raport që dorëzohet prej ministrisë dhe duhet patjetër të kaloj përmes kuvendit sepse është obligim ligjor. Ky nuk është raport i veçantë veq për Rahovecin, këtu janë të gjitha komunat që bëjnë pjesë në performance.

**Burim Krasniqi** – Kryesues, nëse ekziston mundësia që në seancat e radhës kur të vie materiali, rekomandimet e KPF-së të jenë të bashkangjitura.

**Kryesuesi** – Faleminderit. Dikush tjetër diçka?... Nëse jo, atëherë përfundoi edhe rendi i ditës, rrjedhimisht edhe seanca e rregullt për sot. Deri në seancën tjetër, mirupafshim.

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi:** | **K R Y E S U E S I** |
| ______________________ | ______________________ |
| **Albion Krasniqi** | **Defrim Kafexhiu** |

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 11 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019")*, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 13 dhe nenit 23 paragrafi 2 pika 2.1 lidhur me paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:25.11.2022 merr këtë:

## VENDIM

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës me negocim**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/2979/22 i datës 14.11.2019 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite me negocim të Kryetarit të Komunës.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Groblje, me kulturë mal i klasës 1, e evidentuar sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-08924-0, në emër të Komuna e Rahovecit me sipërfaqe të përgjithshme prej 3402m$^2$ (tre mijë e katërqind e dy metra katror) dhe i IPET në shfrytëzim Fondacionit "ADRIAN ORLLATI" me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të Foncacionit znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të shtyer në moshë, të cilët janë pa përkujdesje dhe në gjendje jo të mijë ekonomike, i cili investim është për qëllime humanitare dhe bamirësie dhe se vlera e investimit është 1,100,000.00€ (një milion e njëqindmijë euro), me çka tejkalohet vlera prej 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak 2021 *(Investimet kapitale komunale për vitin 2021 kanë qenë 4,286,979.00€, kurse 10% e kësaj vlere është 428,697.90€)*.

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatgjatë në periudhën prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite dhe ipet në shfrytëzim pa kompensim.

5. Obligohet Fondacioni “ADRIAN ORLLATI” me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati, që në afat prej 3 (tre) vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të filloj punët ndërtimore, në të kundërtën do t'i mirët e drejta e shfrytëzimit të pronës komunale.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

7. Obligohet Kryetari i Komunës që pas miratimit të këtij vendimi të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, respektivisht Fondacionit “ADRIAN ORLLATI” me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të Foncacionit znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati.

8. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Kryetari I Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-____/22**
**Me datë: 25.11.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**________________**
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2979 Nr. i faq/Br.str/No.pg 69
Data/Datum/Date 14 / 11 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 11 dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019")*, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6, nenit 13 dhe nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 74 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.9 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës:

**P R O P O Z O N**

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratimin e vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik në shfrytëzim afatgjatë nga 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite me negocim të Kryetarit të Komunës.

2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, është në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Groblje, me kulturë mal i klasës 1, e evidentuar sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-08924-0, në emër të Komuna e Rahovecit me sipërfaqe të përgjithshme prej 3402m$^2$ (tre mijë e katërqind e dy metra katror) dhe i IPET në shfrytëzim Fondacionit "ADRIAN ORLLATI" me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të Foncacionit znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati.

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është ndërtimi i objektit për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të shtyer në moshë, të cilët janë pa përkujdesje dhe në gjendje jo të mijë ekonomike, i cili investim është për qëllime humanitare dhe bamirësie dhe se vlera e investimit është 1,100,000.00€ (një milion e njëqindmijë euro), me çka tejkalohet vlera prej 10% e buxhetit të përgjithshëm për investime kapitale të komunës për vitin paraprak 2021 *(Investimet kapitale komunale për vitin 2021 kanë qenë 4,286,979.00€, kurse 10% e kësaj vlere është 428,697.90€)*.

4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij propozimi, është afatgjatë në periudhën 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite dhe do të jepet në shfrytëzim pa kompensim.

5. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe Fondacionit "ADRIAN ORLLATI" me seli në Laussane të Zvicrës, me Presidente të Foncacionit znj. Micheline Calmy Rey dhe përfaqësues z. Avni Orllati.

6. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Shërbimi i Kuvendit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

*Me propozim të njoftohen:*

1. ***Kryesuesi i Kuvendit të Komunës,***
2. ***Sekretaria e Kuvendit,***
3. ***Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
4. ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe***
5. ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot / Br. prot. 5164 Më / Dt. 14.11.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Për:** z. Smajl Latifi, Kryetar i Komunës në Rahovec.
z. Defrim Kafexhiu, Kryesues i Kuvendit të Komunës në Rahovec

**Nga:** z. Avni Orllati nga fsh. Brestoc, Komuna e Rahovecit

**Subjekti:** Kërkesë për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Të nderuar!

Unë Avni Orllati nga fsh. Brestoc Komuna e Rahovecit, i lindur me datë 14.05.1974 me vendbanim në Lousanne të Zvicrës, përfaqësues i Fondacionit "Adrian Orllati" me seli në Lousanne të Zvicrës, kam shprehur gatishmëri që të investoj në Komunën e Rahovecit, respektivisht në parcelën Nr. P-71510057-08924-0 në Zonën Kadastrale në Rahovec në sipërfaqe të përgjithshme prej 3402m$^2$ (tremijë e katërqind e dy metra katror).

Në këtë parcelë, Fondacioni "Adrian Orllati" me seli në Lousanne të Zvicrës me Presidente të Fondacionit znj. Micheline Calmy-Rey, kemi paraparë që të ndërtojmë (investojmë) objektin për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të shtyer në moshë, të cilët janë pa përkujdesje dhe në gjendje jo të mirë ekonomike.

Vlera financiare e ndërtimit të këtij objekti i cili parashihet të ndërtohet është rreth 1,000,000.00€ (një milion euro) dhe plani dinamik i ndërtimit të këtij objekti parashihet të bëhet në afat prej 10 deri 12 muaj nga marrja e lejes së ndërtimit dhe përfundimit të të gjitha procedurave ligjore me pajisje me dokumentacion përkatës.

Projekti i ndërtimit të kësaj qendre parasheh ndërtimin e 30 deri 35 banesa për strehim të personave të shtyer në moshë si dhe këtu parashihet të punësohet një personel përafërsish prej 10 (dhjetë) personave të profileve të ndryshme nga ana e Komunës së Rahovecit, të cilët do të jenë të nevojshme për funksionalitetin dhe mirëmbajtjen e këtij objekti.

Andaj, pas takimit me Kryetarin e Komunës dhe negocimit të ofertave të paraparë me legjislacionin në fuqi, kërkoj nga Kuvendi i Komunës në Rahovec marrjen në shfrytëzim afatgjatë pronën komunale Nr. P-71510057-08924-0 në Zonën Kadastrale në Rahovec në sipërfaqe të përgjithshme prej 3402m$^2$ (tremijë e katërqind e dy metra katror) në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite për ndërtimin e qendrës/objektit për strehimin dhe kujdesin ndaj personave të shtyer në moshë, të cilët janë pa përkujdesje dhe në gjendje jo të mirë ekonomike.

Vlen të theksohet se të gjitha shpenzimet, përfshirë mirëmbajtjen, ushqimin, pagesën e stafit për përkujdesjen e të moshuarve i merr përsipër Fondacioni "Adrian Orllati".

Fondacioni "Adrian Orllati" ka bërë edhe investime të tjera të natyrës së ngjashme në shtete të ndryshme, përfshirë edhe shtetin e Zvicrës, ku ne jetojmë dhe veprojmë.

Mbesim me shpresë se kërkesa jonë do të hasë në mirëkuptimin tuaj.

**Bashkëngjitur mund ti gjeni:**

- Procesverbali mbi ofertën e negociuar për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
- Projekti ideor i ndërtimit të qendrës/objektit dhe plani dinamik i realizimit të investimit;
- Certifikata e pronës dhe kopja e planit;
- Certifikata e regjistrimit të Fondacionit;
- Vërtetimi për obligimin tatimor;
- Qarkullimi bankar i vitit paraprak 2021.

**Me respekt!**

Nr. kontaktues

Rahovec
14.11.2022

Kërkesën e parashtroi

Për ____________
Avni Orllati

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

# PROCESVERBAL

Më datë 6.09.2022, në Zyrën e Kryetarit të Komunës z. Smajl Latifi, Presidentes së Fondacionit "ADRIAN ORLLATI", znj. Micheline CALMY REY, z. Avni ORLLATI, përfaqësues i Fondacionit "ADRIAN ORLLATI", me seli në Lausanne, përkatësisht në Zvicër, z. Isak Hoti – Udhëheqës i Sektorit Ligjor pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe z. Mirsad Shala – Zyrtar Ligjor në Sektorin Ligjor është mbajtur takimi me qëllim të fillimit të negociatave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, siç parashihet në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Në fjalën e tij hyrëse të mirëseardhjes, Kryetari i Komunës i uroi mirëseardhje përfaqësuesit të Fondacionit, si dhe interesimin e tij për të investuar në komunën e Rahovecit, ku në të njëjtën kohë u siguroi atyre mbështetjen e parezervë të të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe procedurale të Komunës së Rahovecit, me qëllim të përfundimit sa më të shpejtë dhe efikase të këtij investimi shumë të qëlluar dhe të mirëseardhur për të gjithë banorët e komunës sonë.

5. Çmimi "Sulejman Krasniqi" mund t'ju jepet edhe familjarëve të personave të cilët i kanë kontribuuar krijimtarisë letrare, artit dhe kulturës edhe pas vdekjes.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

*U dërgohet:*

- *MAPL-së*
- *Arkivi*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr. 1427**
**Rahovec; 30.04.2019**

**Afrim Dina**
**Kryesues i Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E RAHOVECIT/ OPŠTINA ORAHOVAC/ MUNICIPALITY OF RAHOVEC

**Njësia e Auditimit të Brendshëm Komuna e Rahovecit**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2668 Nr. i faq/Br.str/No.pg 38
Data/Datum/Date 5 / 9 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

# RAPORT INFORMUES PËR PUNËN E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**Për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021.**

**Janar, 2022**

## Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar - Dhjetor të vitit 2021

Në perudhën Janar – Dhjetor Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2021, i cili plan ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.
Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.
Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2021, kemi arritur të kryejm 10 (dhjetë) auditime, aq edhe sa ishin të planifikuara.

## Auditimi Nr. 1 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin Komunale të Arsimit

**Çështja 1: Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimin e të hyrave**

Kemi bërë vlerësimin dhe krahasimin e procedurave të planifikimit, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

**KONKLUZIONI**
**Inkasimi i të hyrave që nuk bazohet në bazë të Rregullorës, ndikon në uljen e realizimit në të hyra.**
**Mos planifikimi i mirëfillt dhe jo i caktuar sipas taksës komunale, ndikon në shfaqjën e diferencave dhe rrit rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimin e parasë së gatshme.**

**REKOMANDIMI - 1**
**Rekomandojm Drejtorin Komunale të Arsimit të eliminoj dobësit e indetifikuara dhe të mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e Rregullorës, duke mundësuar shtimin në inkasim në të hyra.**

**Çështja 2: Mangësi në Planifikimin dhe realizimin e taksës komunale.**

Planifikimi i të hyrave nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, nuk jan marrur parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshirë edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake dhe vitit vijues, ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit.

**KONKLUZIONI**
**Planifikimi i të hyrave në ulje, nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit, me efekt edhe në procesin përfundimtar të shpenzimeve.**
**REKOMANDIMI – 2**

**Rekomandojm që Drejtoria e DKA-së duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, që të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake dhe vitit vijues që të ketë efekt në realizimin e të hyrave.**

**Çështja 3: Mangësi në menaxhimin dhe raportimin e të hyrave**

DKA-ja nuk kishte bërë barazimin e të hyrave duke përfshirë saldot mujore për të hyrat e inkasuara nga Drejtoria në mënyrë sistematike (çdo muaj) me zyrtarin kryesor për të hyrat. Mos barazimi ka ndikuar që të hyrat e realizuara sipas evidencave të zyrtarit kryesor me evidencat nga departamentet që krijojnë të hyra, të jenë të ndryshme.

**KONKLUZIONI**
**Mos barazimet e të hyrave, ndikon në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e të hyrave në kode të gabuara ekonomike.**

**REKOMANDIMI – 3**
**Rekomandojm DKA - në duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorisë përkatëse me zyrtarin kryesor për të hyrat, të kryhen në baza të rregullta mujore dhe të gjitha mospërputhjet e mundshëm të sqarohen me kohë.**

**Çështja 4: Keq klasifikimi i shpenzimeve**

Pagesat e bëra nga thesari sipas vendimeve gjyqësore janë paguar dhe regjistruar në kategoritë e gabuara ekonomike.
Pagesat për paga jubilare dhe përcjellëse sipas kontratës kolektive, janë realizuara nga Mallrat dhe Shërbimet, e jo nga Pagat dhe Meditjet.

**KONKLUZIONI**
**Regjistrimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve, dhe rrjedhimisht shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës. Shkaku i keq klasifikimit të shpenzimeve kryesisht ishte rezultat i keq buxhetimit dhe mungesës së mjeteve në kategoritë adekuate.**

**REKOMANDIMI – 4**
**Rekomandojm që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.**

**Çështja 5: Mangësi në kompenzimin e Pagave përcjellëse**

Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, ka marr Vendim në bazë të Aktgjykimeve, ka nënshkruar urdhër obligimin për pages dhe urdhër blerjen pa i njoftuar Drejtorat e shkollave, që janë zyrtar kryesor për nënshkrime në bazë të vendimit 025 të datës 20.01.2020.

Gjatë intërvistes me Drejtorët e Shkollave fillore dhe të mesme , deklaruan së Drejtori i DKA-së nuk na ka njoftuar fare që ka nënshkruar në emrin e tyre si Zyrtar autorizues i Departamentit, në urdhër obligimi për pagesë, dhe në urdhër blerje për vendime gjyqësore.

**KONKLUZIONI**
**Nënshkrimit në Urdhër obligimi për pagesë, urdhër blerje, dhe marrja e vendimeve nga i njejti Drejtor rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të zyrtarit autorizues, rrjedhimisht shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Shkollave.**

**REKOMANDIMI -5**
**Rekomandojm që Drejtoria e DKA-së, zyrtari i autorizuar i Departamentit i caktuar në bazë të vendimit nr. 025 të datës 20.01.2020, për emrimin e përsonave zyrtar, të nënshkruaj zyrtari kryesor në urdhër blerje dhe në urdhër obligimi për pagesë.**

**Çështja 6: Mangësit në dosje të punëtorve**

DKA-ja nuk ka arritur të vendosë kontrolle adekuate sa i përket menaxhimit në mirëmbajtjen e dosjeve të punëtoreve. Gjatë ekzaminimit të dosjes së punëtorve është gjetur, se në shumicen e shkollave nuk ishin të kompletuara (letër njoftimi i skaduar, çertifikata e vjetër, diplomat të pa noterizuara) gjë që vërtetohet edhe nga regjistri i zyrtarit për mirmbajtjen e dosjeve.

KONKLUZIONI
**Janë vërejtur veprime të mangëta të kontrollit e cila është çeshtje e menaxhmentit për përmirësime të rëndësishme, dhe është kërkuar veprime të menjëhershme përmirësuese për tu mbrojtur në mënyrë adekuate kundrejt ekspozimit.**

REKOMANDIMI – 6
**Rekomandojm që dosjet e puntorëve në Shkolla, të paisen me dokumente të kompletuara burimore për të treguar gjendjen faktike të punëtorëve.**

---

## Auditimi Nr. 2 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Shërbime Publike, Komunale

**Çështja 1: Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimin e të hyrave.**

Kemi bërë vlerësimin dhe krahasimin e procedurave të planifikimit, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.

Gjatë analizimit te të dhënave kemi bërë një krahasim me vitin paraprak (2020), ne kemi vërejtur se në aspekt të përgjithshëm ka pasur një rritje të të hyrave në periudhën e audituar.

KONKLUZIONI
**Planifikimi i gabuar i të hyrave dhe që nuk bazohet në analiza të mirëfillta, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit.**

REKOMANDIMI – 1
**Rekomandojm Drejtorin e Shërbimeve Publike, Komunale që ta rishikoj planifikimin e të hyrave që kodët ekonomike të jenë të dedikuara për Drejtorin përkatëse dhe plani i të hyrave të jetë i bazuar në analiza dhe vlerësime të sakta nga njësit vartëse që i grumbullojnë ato, për të përmirësuar nivelin e realizimit të tyre.**

**Çështja 2: Menaxhim jo efikas i pronës shtetërore të vendosura objektët e përkohëshme në sipërfaqën publike.**

Procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronën shtetrore për vendosjen e objekteve të përkohshme për periudhën deri në një (1) vit ''rregullohen dhe përcaktohen me rregullore komunale" Komuna ka aprovuar rregullore të brendshme për vendosjen e objekteve të përkohëshme në teritorin e Komunës së Rahovecit.

KONKLUZIONI
**Neglizhimi i procedurave të shkruara në mos lidhjen e kantratave të objekteve të përkohshme të vendosura në pronën shtetrore, dëmton konkurrencën dhe trajtimin e barabartë të të interesuarve. Mos vazhdimi i kontratave në vitin vijues rrit rrezikun e mos inkasimit të të hyrave duke i sjell humbje financiare komunës.**

REKOMANDIMI - 2
Rekomandojm Drejtorin e Shërbimeve publike duhet të siguroj që kontraktuesit të lidhin kontratë me kohë në bazë të kontratës paraprake, për dhënien në shfrytëzim sipërfaqën publike, ose të zhvillohet procedura në bazë të konkurencës dhe trajtimit të barabart të të interesuarve.

Çështja 3: Vendosja e mallrave për ekspozim para hapsirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomoke.

KONKLUZIONI
Vendosja e mallrave për ekspozim para hapsirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në sipërfaqen e hapur publike, rrezikon levizjen e lire të këmbësoreve

REKOMANDIMI -3
Rekomandojm që Drejtoria e Shërbimeve Publike me Drejtorin e Inspektimit që të ndërmarin masa administrative dhe ligjore, që ta shmangin rrezikun e levizjes së lire të këmbësoreve.

Çështja 4: Dobësi në procesin e planifikimit

Siç kemi paraqitur të theksimi i çështjes, Leje punë për auto taxi, leje pune për kombibus-taxi, dhe vërtetim i orarit të udhëtimeve për autobusë dhe minibusë, në periudhën audituese kishte të inkasuara të hyra, kurse të planifikuara nuk kishte në këtë drejtim.

KONKLUZIONI
Inkasimi i të hyrave pa planifikuar rezulltojnë me prezantimin e gabuara të të hyrave në pasqyrat financiare. Raporti jo i drejtë i të dhënave për mos planifikimin e të hyrave ndikon në vendimmarrjen e menaxhmentit.

REKOMANDIMI – 4
Rekomandojm që Drejtoria për Shërbime Publike duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkesat të planifikohen dhe kategorizohen sipas ngarkesës paraprake të të hyrave. Kjo duhët të reflektoj për buxhetin, kërkesat në kategorit përkatëse ekonomike dhe fuqizimin e kontrollit për të hyra.

Çështja 5: Dobësi në menaxhimin e kontratave

Sipas nenit 28.10 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), definohet qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedoj një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të proceduarve të kontraktimit të punëve.

KONKLUZIONI
Dobësitë e identifikuara në proceset e menaxhimit të kontratave, në mungesë të projekteve ekzekutuese, ndikon në menaxhimin jo të mirë të projekteve, po ashtu edhe vonesave në realizim të tyre.

REKOMANDIMI – 5
Rekomandojm Drejtorin e Shërbimeve Publike, duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e menaxhimit të projekteve që kanë të bëjnë me punë, të mos iniciohen procedurat pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues.

## Auditimi Nr. 3 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Urbanizëm, Planifikim Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit.

**Çështja 1: Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimin e të hyrave**

Kemi bërë vlerësimin dhe krahasimin e procedurave të planifikimit, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor.
Nëse e shikojm trendin e arkëtimit në periudhën audituese të vitit 2021 vërehet një ulje e të hyrave në krahasim me periudhën e njejtë të vitet paraprak për 4,10%.

**KONKLUZIONI**
**Keq përcaktimi i planifikimit rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të të hyrave, dhe rrjedhimishtë shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.**

**REKOMANDIMI 1**
**Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të mjedisit duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në ndarjet adekuate të planifikimit, në mënyr që të bëhet regjistrimi dhe inkasimi i mirëfillt i të hyrave vetanake.**

**Çështja 2: Zbatimi i Taksaës për leje të ndërtimit dhe legalizim të objekteve**

Drejtoria e Urbanizmit lëshon lejet e ndërtimit sipas ligjit të ndërtimit nr. 04/L-110 dhe cakton taksën administrative të rekomanduar nga ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
Në periudhën audituese të vitit 2021 ishin vetëm 18 (tetëmbëdhjet) kërkesa për leje ndërtimi, dhe të aprovuara.
Në bazë të raportit të zyrës për mjedis në Drejtorin e audituar, në vitit 2021 me qëllim të pajisjes me leje mjedisore komunale kishin aplikuar dhe ishin aprovuar vetëm 2 (dy) kërkesa.

**KONKLUZIONI**
**Mos ndërmarrja e masave të kërkuara ndaj të hyrave përkundër planifikimit, ndikon që të hyrat e planifikuara nga këto taksa të jenë më të ulëta duke reduktuar edhe mundësin e financimit të projekteve të planifikuara nga të hyrat vetanake.**

**REKOMANDIMI 2**
**Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit Hapsinor dhe Mbrojtje të Mjedisit duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të rritet numri i kërkesave për leje ndërtimi dhe leje mjedisore komunale, në mënyr që inkasimi i të hyrave të ngritet.**

## Auditimi Nr. 4 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

**Çështja 1: Mangësi në Planifikimin dhe regjistrimin e të hyrave**

Kemi bërë vlerësimin dhe krahasimin e procedurave të planifikimit, si dhe kemi testuar funksionimin e procesit të mbledhjes së të hyrave nga regjistrat kontabël deri në dokumentacionin burimor, për periudhën audituese të vitit 2021.

**KONKLUZIONI**
**Mos mbajtja e duhur e shënimeve në krahasimin dhe harmonizimin e të hyrave në regjistra të njësive vartëse të Drejtorisë, krijon mundësinë që këto të hyra të mos raportohen drejtë. Mungesa e evidencave të qarta dhe të mjaftueshme për të hyrat, është si rezultat i raportimeve jo të sakta dhe të besueshme.**

**REKOMANDIMI – 1**
**Rekomandojm që Drejtoria e Bujqësisë, Pylltaris dhe Zhvillim Rural, duhet të siguroj menaxhim të mirë të të hyrave, bazë të qartë në krahasimin dhe vlerësimin e vlerës së të hyrave të realizuara dhe me rastin e planifikimit të merren parasysh të gjitha aspektet duke përfshirë kodet adekuate të të hyrave.**

**Çështja 2: Inkasimi i dobët të të hyrave**

Aktiviteti i kontrollit të brendshëm nuk ka bërë vlerësim dhe krahasim vjetor të të hyrave të realizuara për të caktuar planifikimin të paraqitur në raport, për parandalimin dhe identifikimin e diferencave në raportim. Në bazë të Rregullorës të hyrat ishin shumë të ulëta, duke përjashtuar participimin nga bujqësia që nuk përfshihet si e hyrë në Rregullore, Planifikimi i të hyrave në vitin 2021, ishte rritur për 62,07%, kurse inkasimi kishte zbritje për 56,89%.

**KONKLUZIONI**
**Proceset e dobëta të kontrolleve gjatë caktimit të hyrave të planifikuara , planifikimi jo adekuat mund të rezultojë me dobësi në kontrollin dhe monitorimin e përformancës se të hyrave.**

**REKOMANDIMI – 2**
**Rekomandojm Drejtorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të eliminoj dobësit e indetifikuara dhe të mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e Rregullorës, duke mundësuar shtimin në inkasim në të hyra.**

---

## Auditimi Nr. 5 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

**Çështja 1: Mangësi në tjetërsimin e pasurisë jo financiare**

Në bazë të vendimit të Kryetarit nr. 698 të datës 05.07.2021 është formuar komisioni për tjetërsimin e pasurive jo financiare. Komisioni për tjetërsimin e pasurive jo financiare nuk ka kryer punën që i është caktuar në bazë të vendimit nga Kryetari i Komunës.

**KONKLUZIONI**
**Mos kryerja e punës nga ana e komisionit, mos bartja e pasurive të pa përdorura në depon e ckatuar, vështirëson identifikimin e saktë të pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.**

**REKOMANDIMI – 1**
**Rekomandojm që Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm të funksionalizoj depon, dhe të gjitha pasurit e pa përdorura të vendosën në depo.**

**Çështja 2: Mangësi në Planifikimin, regjistrimin dhe realizimin e të hyrave**

Gjatë rishikimit të trendit të arkëtimit, vërehet një rritje e dukshme në krahasim me periudhën e njejtë të viteve paraprake.
Nuk ekziston një planifikim i mirëfillt i analizuar i definuar dhe i destinuar drejtë, për të hyrat e përgjithshme dhe këtë e vërteton diferenca ndërmjet planifikimit dhe realizimit.

**KONKLUZIONI**
**Performanca pjesërishtë e mirë e realizimit të të hyrave sipas planit vjetor ndikon në përmirësimin e aspektit buxhetor të komunës e po ashtu edhe në realizimin e objektivave të Drejtorisë.**
**Planifikimi i të hyrave që nuk bazohet në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit, me efekt edhe në procesin përfundimtar të shpenzimeve.**

**REKOMANDIMI – 2**
**Rekomandojm që Drejtoria e audituar se duhet të sigurojë se performanca e mbledhjes së të hyrave monitorohet dhe rishikohet në mënyrë sistematike.**

**Drejtoria e audituar duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, do të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.**

**Çështja 3: Mos barazimi i të hyrave në mes drejtorive përkatëse .**

Drejtoria për ekonomi, zhvillim dhe Turizëm nuk bën barazimin dhe harmonizimin e të dhënave në mënyrë sistematike, me zyrtarin kryesore për të hyra siç kërkohet me rregullën Nr. 03/2010 neni 13.3. Kjo situatë është për shkak të neglizhencave të zyrtareve të drejtorisë përkatëse.

**KONKLUZIONI**
**Mos harmonizimet e të hyrave, ndikojnë në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e klasifikimeve të mundshme në kode të gabuara të transaksioneve.**

**REKOMANDIMI – 3**
**Rekomandojm Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorisë përkatëse dhe zyrtarit kryesor për të hyra të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.**

**Çështja 4: Inkasimi dhe Realizimi i të hyrave**

Trendi jo i knaqshën ndaj planifikimit, ka ndikuar në inkasimin jo të rregullt të obligimit dhe të borgjit. Gjatë auditimit është gjetur së planifikimi nuk ishte i mbështetur në analiza konkrete, që ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit.

**KONKLUZIONI**
**Rritja e borgjit, është si rezultat i mos angazhimit të mjaftueshëm të zyrtareve përgjegjës dhe nivel të ulët të kontrollit e që rezulton me informta për të hyrat nga qiradhënia e pronave publike. Vazhdimi i kontratave ndaj qiramarrësve të mëparshëm ku shumica e të cilëve nuk ju kanë përmbajtur afatit të pagesave sipas kontratave, rritë rrezikun e mos inkasimit te të hyrave, si dhe mungesa e monitorimit ndaj shfrytëzuesve te hapësirave publike rritë rrezikun që komuna të ketë humbje financiare.**

**REKOMANDIMI – 4**
**Rekomandojm që Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, duhet të ndërmerr masa në rritjen e përgjegjësive të zyrtarët, kryesisht me qiramarrësit të cilëve ju kanë vazhduar kontratat, dhe të vendos masat e duhura që brenda një periudhë të arsyeshme, që deri me datë 05 të çdo muaji vijues të inkasoj të gjitha obligimet e mujore dhe të inkasoj borgjet.**

**Çështja 5: Mos arkëtimi i të hyrave sipas kontratave**

Gjatë auditimit të kontratave për shfrytëzimin e pronës publike, identifikuam se ishin 34 (tridhjetë e katër) prona komunale të evidentuara në rëgjistër. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm nuk kishte arritur të arkëtojë të hyrat për borxhin e akumuluar. Mungesa e kontrolleve dhe neglizhenca e Drejtorisë, ka ndikuar në mos arkëtimin e të hyrave.

**KONKLUZIONI**
**Menaxhimi i dobët i kontratave të qirave rezulton në rritjen e të arkëtueshmeve si dhe ka shkaktuar rritjen e papërgjegjshmërisë së qiramarësve të cilët shfrytëzojnë pronat publike pa respektuar kontratat.**

**REKOMANDIMI – 5**
**Rekomandojm Drejtorin për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, duhet të sigurojë se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Duhet të gjenden forma, që të merren masa të menjëhershme (një mundësi e tillë përmes përmbaruesit) që detyrojnë obliguesit të respektojnë detyrimet kontraktuale.**

**Çështja 6: Realizim i ulët i të hyrave dhe dobësi në menaxhimin e tyre**

Në periudhën audituar të vitit 2021 janë inkasuar të hyra prej 54.48% të buxhetit të planifikuar. Shohim se ka pasur trend të knaqshëm ndaj planifikimit. Kurse, trendi i knaqshëm ndaj planifikimit, nuk ka ndikuar në inkasimin e rregullt të borgjit. Trendi i të hyrave ka ngritje përderisa borxhet ndaj komunës mbeten pa u mbledhur, kjo situate është sjell si rezultat i mos angazhimit të mekanizmave për inkasimin e të hyrave.

Gjatë auditimit është gjetur së planifikimi nuk ishte i mbështetur në analiza konkrete dhe monitorim përmes raportimeve mujore, që ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe ngarkesës.

**KONKLUZIONI**
**Mungesa e një strategjie për të inkasuar shumat e akumuluara nga viti në vit mund të rrezikoj që këto të hyra të shndërrohen në borxhe të këqia dhe të bëhen të pa mbledhshme.**

**REKOMANDIMI – 6**
**Rekomandojm që Drejtoria e audituar të aplikoj masa efektive që taksat e biznesit të inkasohen sipas periudhave të vitit, duke mos injoruar edhe borxhat e mëhershme.**

---

## Auditimi Nr. 6 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Shëndetësi dhe Mirqenie Sociale. (QKMF).

**Çështja 1: Mungesa e evidencave, barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në njësitë e QKMF-së**

Ne kemi vërejtur se për të hyrat nga participimi në QKMF nuk janë mbajtur evidenca adekuate.
Drejtoria përkatëse në Komunë duhet që çdo muaj të bëjë barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave.

**KONKLUZIONI**
**Mos mbajtja e duhur e shënimeve për të hyra në regjistra të njësive vartëse dhe Procesimi aktual i informatave për të hyrat, krijon mundësinë që këto të hyra të mos raportohen drejtë. Po ashtu, është e rëndësishme që të hyrat e mbledhura deponohen me vonesë në llogari të DSHMS. Jo në pajtim me rregullat e përcaktuara.**

**REKOMANDIMI - 1**
**Rekomandojm DSHMS të sigurojë që plani i të hyrave është i bazuar në analiza dhe vlerësime të sakta nga njësit vartëse që i grumbullojnë ato, për të përmirësuar nivelin e realizimit të tyre.**

**Çështja 2: Zbatimi i Vendimit**

Duke u bazuar në procedurat e kryera të auditimit ne indentifikuam se Vendimi i lëshuar në vitin 2017, është funksionalizuar, moduli për evidentimin e pacienteve në Sistemin e Informimit Shëndetësor (SISH), përmes të cilit kërkohet të evidentohen të dhënat e çdo pacienti në librin e protokolit.

Gjatë rishikimit në librin e protokolit në teren (QKMF, QMF dhe AMF), është punuar në këtë drejtim por me mangësi të shumta.

**KONKLUZIONI**
**Dobësitë e identifikuara vështirësojnë menaxhimin adekuat në regjistrimin e të gjith pacienteve. Metoda e aplikimit të SISH-it, në kushte të tilla, i ekspozohet rrezikut që SISH-i, most të funkcionojë.**

**REKOMANDIMI - 2**
**Rekomandojm Drejtorin e audituar të sigurojnë se subjektet përgjegjëse konkretisht (QKMF, QMF dhe AMF), të krijojnë mekanizma të duhura dhe të qëndrueshme, që të funkcionalizohet SISH-i në tërësi, për të pas të dhëna të sakta për të gjithë pacientët.**

**Çështja 3: Menaxhimi dhe Azhurnimi i Listes Esenciale të Barnave.**

Zyrtari për menaxhimin e barnave nuk na ka ofruar raport hyrje - dalje për periudhën audituese të vitit 2021. Nuk na është dhënë informatë apo raport në lidhje me raportin e stoqeve të barnave në fund të vitit 2020. Kjo mund të ndikoj që informatat në lidhje me gjendjen e stokut përfundimtar të barnave të vitit 2020 të mos jenë të sakta dhe të besueshme.

**KONKLUZIONI**
**Procesi i parashtrimit të kërkesave për barna megjithëse pretendohet se ishte i organizuar në periudha të rregullta, informacioni i mbledhur gjatë auditimit tregon se SISH-i nuk ka funkcionuar siç kërkohet. Mungesa e raporteve dhe procesi i raportimit rreth pranimit dhe distribuimit të barnave na shpie në një situat konfuze për të nxjerrur gjendjen reale po ashtu edhe mundësi keqpërdorimi.**

**REKOMANDIMI – 3**
**Rekomandojm DSHMS, të forcoj funkcionimin e SISH-it, në mënyr që të nxirrën të dhënat e sakta për të nxjerr raporte periodike dhe vjetore që të kryhet auditimi në mënyr të rregullt.**

**Rekomandohet DSHMS, që ne të ardhmen, në fund të çdo viti të formoj një komision për regjistrimin e barnave ne depo, barnatore dhe në të gjitha repartet dhe njësitë vartëse QMF dhe AMF dhe të pregaditet një raport që tregon gjendjen e stoqeve qe barten për vitin në vijim, po ashtu të ketë raporte periodike gjat vitit për hyrje-dalje të barnave.**

**Çështja 4: Mangësi në barazimin dhe harmonizimin e të hyrave të QPS-së.**

Sipas raportit të arkës në DSHMS-së, dhe raportit të zyrtarit për të hyra ne drejtorinë Financave, rezulton që nuk ka asnjë të hyrë nga QPS-ja, kurse sipas raportit të zrtarit të financave të DSHMS rezulton se ka pasur të hyra, ndërsa të hyrat e këtij viti nuk kaë informacion se në llogari të kujt derdhen mjetet e inkasuara nga QPS, por si përfundim rezulton se këto të hyra janë bartur gabimisht në kodin e drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

**KONKLUZIONI**

**Mos realizimi i barazimeve mujore ne mes te drejtorisë komunale me zyrtarin e te hyrave rrezikon devijime të caktuara në kontrolle të brendshme duke shkaktuar mangësi të informacionit në kohë, mbi llojet dhe shumat e të hyrave. Parregullsitë e tilla mund të rrisin rrezikun e humbjes apo edhe keq përdorimin e parasë së gatshme.**

**REKOMANDIMI - 4**

**Rekomandojm DSHMS-së të sigurojë se barazimet dhe harmonizimet në mes të arkës dhe zyrtarit që krijon të hyra të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.**

**Rekomandojmë DSHMS dhe QPS që të hyrat të cilat inkasohen nga QPS të ken kodin e vet dhe të regjstrohen në emër të QPS konkretisht DSHMS, po ashtu të pregaditet raport financiar rreth inkasimit të të hyrave nga zyrtari i QPS.**

**Rekomandojm QPS-ja të sigurojë monitorim përmes zyrtarit të financave për të siguruar se paratë e gatshme të arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve të deponohen në llogarinë të QPS-së.**

**Çështja 5: Mangësit në menaxhimin e automjeteve.**

Gjatë ekzaminimit është gjetur, se zyrtari për menaxhimin e automjeteve, nuk ka raport për shfrytëzimin e automjeteve.

KONKLUZIONI
**Janë vërejtur veprime të mangëta të kontrollit dhe është çeshtje e menaxhmentit për përmirësime të rëndësishme, gjë që kërkon veprime të menjëhershme përmirësuese për tu mbrojtur në mënyrë adekuate kundrejt ekspozimit.**

REKOMANDIMI – 5
**Rekomandojm që Drejtoria e audituar të kërkoj nga zyrtari i autoparkut të raportoj në baza të rregullta mujore, po ashtu të bëj kontrolle të mbrendshme tek zyrtari autoparkut në mënyr që ti iket ekspozimit nga keqpërdorimet e mundshme, zyrëtari i autoparkut të mbajt evidenc në elektronikë.**

---

## Auditimi Nr. 7 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

**Çështja 1: Mangësi në Planifikimin dhe realizimin e të hyrave.**

Planifikimi i të hyrave nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit.

KONKLUZIONI
**Planifikimi i të hyrave në ulje ndaj vitit paraprak, Departamenti i buxhetit nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, që ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit.**

REKOMANDIMI – 1
**Rekomandojm që Drejtoria e Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, duhet të siguroj se departamenti i buxhetit me rastin e planifikimit të të hyrave, që të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe planifikimin e të hyrave gjatë viteve paraprake, që të ketë efekt në realizimin e të hyrave.**

**Çështja 2: Mos barazimi i të hyrave në mes drejtorive përkatëse .**

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë nuk ka bërë barazimin dhe harmonizimin e të dhënave në mënyrë sistematike (në periudha tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore), me zyrtarin kryesore për të hyra siç kërkohet me rregullën Nr. 03/2010 neni 13.3. Kjo situatë është për shkak të neglizhencave të zyrtareve të drejtorisë përkatëse.

Në përiudhën audituese të vitit 2021, diferenca e mos barazimit ishte në shumën prej 2.782,00€ apo 0,15% e të hyrave.

KONKLUZIONI
**Mos harmonizimet e të hyrave, ndikonë në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e klasifikimeve të mundshme në kode të gabuara të transaksioneve.**

**REKOMANDIMI – 2**
**Rekomandojm Drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, të sigurojë se barazimet në mes të drejtorisë përkatëse dhe zyrtarit kryesor për të hyra të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.**

**Çështja 3: Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut.**

Menaxhmenti dhe zyrtaret e lartë të entitetit të audituar bazuar në pranimin dhe delegimin e kompetencave, përgjegjësive dhe autorizimeve nuk kanë projektuar dhe hartuar një procesë në vlerësimin e rrezikut dhe identifikimin e rrezikut, vendosjen e procesit kontrollues dhe zbatimin në formë të dokumentuar dhe të shkruar, mos ekzistimin e një regjistri të riskut me qëllim të arritjes së objektivave specifike të përcaktuara.

**KONLUZIONI**
**Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëloj përformancen e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtoj ofrimin e cilësisë së përformancë së suksesit.**

**REKOMANDIMI -3**
**Rekomandojm që menaxhimi të jetë më efektiv në ofrimin e cilësisë së performances në vendosjen e procesit kontrollues në arritjen e objektivave specifike.**

---

## Auditimi Nr. 8 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Administrat të Përgjithshme.

**Çështja 1: Mangësi në Planifikimin e të hyrave**

Kemi vërejtur se në lloje të ndryshme te të hyrave nuk ishin bërë planifikime adekuate dhe nuk ishin marrë masa të mjaftueshme për realizimin e të hyrave. Kjo vërehet tek ngecja në mbledhjen e të hyrave, i cili plan nuk ishte përmbushur. Konstatohet së planifikimi i të hyrave nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe inkasimit. përmbushur.

**KONKLUZIONI**
**Keq përcaktimi i planifikimit rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të të hyrave, rrjedhimishtë shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.**

**REKOMANDIMI 1**
**Rekomandojm që Drejtoria e Adminisratës të Përgjithshme duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet në ndarjet adekuate të planifikimit, në mënyr që të bëhet regjistrimi dhe inkasimi i mirëfillt i të hyrave vetanake.**

**Çështja 2: Mangësi në barazimin dhe harmonizimin e të hyrave.**

Drejtoria përkatëse në komunë duhet që çdo muaj të bëjnë barazimin e të hyrave me zyrtarin e të hyrave. Përveç regjistrimit të të hyrave vetanake si dhe harmonizimit mujor dhe tremujor në Thesar, kërkohet edhe harmonizimi i të hyrave në mes të Departamenteve dhe Zyrtarit të të Hyrave në Komunë i cili duhet të bëhet për çdo muaj. Aktualisht kjo Drejtori ka bërë barazim detal të hyrave me zyrtarin e të hyrave.

**KONKLUZIONI**
**Mos realizimi i barazimeve mujore ne mes te drejtorisë të Adminstratës, me zyrtarin e te hyrave rrezikon devijime të caktuara në kontrolle të brendshme duke shkaktuar mangësi të informacionit në kohë, mbi llojet dhe shumat e të hyrave.**

**REKOMANDIMI – 2**
**Rekomandojm Drejtorin e Administratës, duhet të sigurojë se barazimet në mes të drejtorisë përkatëse dhe zyrtarit kryesor për të hyra të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.**

**Çështja 3: Procedura e marrjes, mirëmbajtjes, parkimit, servisimit dhe raportimit të automjeteve zyrtare.**

Njësia e transportit (zyrtari), ka mbajt vetëm evidenc mujore për çdo automjet zyrtar lidhur me shpenzimet e derivative të naftës, KM. të kaluara dhe normativin e shpenzimeve.
Çdo nëpunës i cili e ka shfrytëzuar automjetin për udhëtim zyrtar, ka bërë kërkesë vetëm me gojë tek përgjegjësi (eprori) i drejtorisë ku është i sistemuar, nuk e ka plotësuar formularin apo kërkesën për shërbim të vozitjes të nënshkruar nga eprori i tij.
Mos dorëzimi i çelsave dhe dokumentacioni teknik, e bënë të pa mundur ushtrimin e përgjegjësisë së zyrtarit të njesisë së transportit, në automjete zyrtare.

**KONKLUZIONI**
**Përdorimi i automjeteve zyrtare në mos pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores Komunale, rrit rrezikun që automjetet e Komunës të keqpërdoren, në mungesë të një politike efektive të menaxhimit të automjeteve, dhe shpenzimet e karburanteve të mos janë duke u kontrolluar në mënyrë efektive.**

**REKOMANDIMI – 3**
**Rekomandojm Drejtorin e Administratës të jetë në mbkëqyerje të plotë, drejtorit që shfrytëzojn automjetet zyrtare për nevoja zyrtare, të respektojn në plotni Rregulloren Komunale 01 Nr. 342 të dates 30.01.2013 dhe Urdhëresën nr.04/106/9 të dates 26.03.2019, për përdorimin e automjeteve zyrtar.**

---

## Auditimi Nr. 9 Auditimi i Brendshëm në Drejtorin për Financa dhe Buxhet

**Çështja 1: Planifikimi dhe realizimi i të hyrave nga tatimi në pronë.**

Konstatohet së planifikimi i të hyrave nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe vlera e faturimit, ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes faturimit, planifikimit dhe inkasimit.

Departamenti i buxhetit në rastin e planifikimit të të hyrave, nuk ka marr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshir edhe realizimin e të hyrave gjatë viteve paraprake.

**KONKLUZIONI**
**Planifikimi i të hyrave që nuk bazohet në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe vlerën e faturuar, ndikon në shfaqjen e diferencave në mes faturimit, planifikimit dhe realizimit .**

**REKOMANDIMI – 1**
**Rekomandojmë që Drejtoria për Financa dhe Buxhet të caktoj planifikimin real krahasuar me vlerën e faturuar dhe të mbajnë evidenca të plota dhe të sakta mbi të hyrat.**

**Çështja 2: Inkasimi dhe ralizimi nga taksat e automjeteve motorike (taksat rrugore).**

Realizimi i të hyrave nga taksat për automjete motorrike për periudhën audituese të vitit 2021, progresi ishte 105,60% të buxhetit të planifikuar.

KONKLUZIONI
**Drejtoria për Financa dhe Buxhet kërkohet të vendos kontrolle të mira mbi të hyrat, kërkesat dhe taksat me gjithë përmirësimet. Të nxjerrë politika të qarta me mekanizmat e duhur për raportime të sakta dhe të besueshme.**

REKOMANDIMI – 2
**Rekomandojm Drejtorin për Financa dhe Buxhet të eliminoj dobësit e indetifikuara dhe të mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin rregullave, duke mundësuar shtimin në inkasim në të hyra, mbikëqyerjen e kërkesave dhe taksave.**

**Çështja 3: Mos barazim i të hyrave ne mes të Departamenteve dhe zyrtarit te të Hyrave.**

Drejtoria e audituar nuk ka arritur të bën barazim e të dhënave duke përfshirë saldot mujore për të hyrat, nuk janë harmonizuar në mënyrë sistematike (çdo muaj) gjatë periudhës audituese të vitit 2021 me zyrtarin kryesor për të hyra.

KONKLUZIONI
**Mos realizimi i barazimeve mujore ne mes te drejtorisë komunale me zyrtarin e te hyrave rrezikon në kontrolle të brendshme, duke shkaktuar mangësi mbi llojet dhe shumat e të hyrave.**

REKOMANDIMI – 3
**Rekomandojm që Drejtoria për Financa dhe Buxhet që realizon të hyra të bëjnë barazimin me zyrtarin e të hyrave në baza të rregullta mujore bazuar në raporte të ndërsjella, duke eliminuar me kohë dobësitë apo gabimet e mundshme.**

---

## Auditimi Nr. 10 Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit

**Çështja 1: Mungesa në disponushmerin të fondeve.**

KONKLUZION
**Vlera ma e vogël e disponueshmërisë të fondeve në rezultatin e vlerësimit të nevojave, Autoriteti kontraktues nuk i ka përmbushur obligimet e tij sipas paragrafit 2, gjë që ndikon në mos lidhjen e kontratës.**

REKOMANDIMI - 1

**Rekomandom Zyrën e Prokurimit që çdo inicim të prokurimit në lidhjen e kontratës, Deklarata e disponueshmërisë së fondeve të jetë ma e lartë ose e barabart me shumën që do të lidhet kontrata (paragrafi 2).**

Çështja 2: Mungesa në zotimin e Fondeve.

Fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Fillimisht ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe urdhër blerja Shkaku i një dukurie të tillë është planifikimi jo adekuat i buxhetit dhe inicimi i procedurave duke shpërfillur zbatimin e rregullave në fuqi.

KONKLUZIONI
**Hyrja në obligime pa fonde të zotuara rritë rrezikun që projektet të mos financohen në tërësi dhe të rezultojë me dështim të kryerjes së tyre. Gjithashtu rritet niveli i rrezikut se mund të krijohen shpenzime të interesave, gjobave për shkak të vonesave për pagesa.**

REKOMANDIMI -2
**Rekomandojm Zyrën e prokurimit të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.**

Çështja 3: Vonesa në fillimin e procesit të vlerësimit, vonesa në vlerësim dhe njoftimet për nënshkrimin e Kontratave janë publikuar me vonesë.

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga Autoriteti Kontraktues brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti me kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Vlerësimi i tenderit nga ana e komisionit për vlerësim duhet të filloj jo më vonë se 5 ditë pas hapjes së ofertave.

Kemi gjetur disa raste nga mostrat e testuara, se zyra e prokurimit ka filluar procesin e vlerësimit të tenderit me vonesë, vonesat janë mbi 5 ditë.

Autoriteti kontraktues Brenda dy (2) diteve pas dhënies së kontratës së të tillë, do të përgadisë njoftimin mbi dhënjen e kontratës, kishte vonesa në disa raste.

KONKLUZIONI
**Proceset e vonuara gjatë vlerësimit të tenderit, mund të rezultojë me dobësi në kontrollin dhe monitorimin e përformancës së komisionit për vlerësim.**

REKOMANDIMI - 3
**Rekomandojm Zyrën e prokurimit, duhet të sigurojë se procesi i vlerësimit të tenderëve të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë, vlerësimi të kryhet brenda afateve kohore të parapara.**

Çështja 4: Mungesa e planit të menaxhimit të kontratës.

Sipas Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik neni 61.7 kërkohet që pas pranimit të kontratës, menaxheri i projektit do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Plani i menaxhimit të kontratës duhet të përgatitet dhe nënshkruhet nga Menaxheri i Projektit dhe Operatori Ekonomik, dhe brenda dy ditëve të punës, duhet të përcjellet një kopje tek departamenti i prokurimit. Kjo vlen për të gjitha kontratat me vlerë të madhe dhe të mesme.

**KONKLUZIONI**

**Mos përgatitja e Planeve për Menaxhimin e Kontratës para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtim të palëve të kontratës, menaxheri i kontratës nuk do ta ketë në kontroll të plotë situatën, lidhur me kryerjen e punëve.**

**REKOMANDIMI – 4**

**Rekomandojm që Menaxherat Kontratave duhet të përgatisin, monitorojnë dhe raportojnë në lidhje me planin për menaxhim të kontratës, konform kërkesës ligjore.**

**Çështja 5: Mungesa e projekteve ekzekutive të ndërtimit.**

Gjatë auditimit nuk kemi hasur në plane detale të ndërtimit. Ligji i Prokurimit nenit 28.10 i cili definon qartë se autoriteti kontraktues duhet të posedoje një projekt ekzekutiv të ndërtimit para fillimit të proceduarve të kontraktimit të punëve. Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës të zyrës së Pokurimit, lidhur me këtë problematikë.

**KONKLUZIONI**

**Inicimi i procedures së prokurimit në mungesë të projektit rezulton me anashkalim të kërkesë ligjore dhe mund të rezultojë me realizim të dobët të kontratave për punë të pa projektuara.**

**REKOMANDIMI – 5**

**Rekomandojm Zyrën e prokurimit të siguroj kontrolle dhe monitoroj zbatushmerinë e kërkesave ligjore duke rishikuar implementimin e ligjit të prokurimit. Me rastin e inicimit të proceduarve të prokurimit për kontraktimin e punëve/ndërtimit duhet të sigurohet paraprakisht se njësit kërkuese kanë të hartuar projektin në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara në rast të kundërt procedurat e tilla nuk duhet të fillojnë.**

**Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është bërë në Planin Strategjik i NJAB për vitet 2022 – 2024.
- Raporti i gjashtëmujorshit të dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2021, i janë dorëzuar Njësisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2021, nga 10 auditime të kryera janë dhënë 40 rekomandime 8 janë zbatuar kurse 32 janë në proces.
- Si aktivitete tjera mund të ceken ofrimin e ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në inplementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke e krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuara ashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të Drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e inplementimit të rekomandimeve.

**Vlerësimi përmbyllës**

Kërkohet një angazhim më konkret i menaxhmentit të Drejtorive Komunale dhe menaxhmentit të lartë të Komunës për implementimin e rekomandimeve për vitin 2021, të dhëna nga Auditori i Brendshëm.

NJAB.

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2934 Nr. i faq/Br.str/No.pg 65
Data/Datum/Date 7 / 11 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

# Raport për zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit

Rahovec, 2022

## Përmbajtja:

**HYRJE** ........ 3

**I. Fushat e përgjithshme të rrezikut** ........ 4

1.1. Fusha e rrezikut: Menaxhimi ........ 4

1.2. Fusha e rrezikut: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve ........ 5

1.3. Fusha e rrezikut: Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave ........ 6

1.4. Fusha e rrezikut: Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit ........ 7

**II. Fushat e veçanta të rrezikut** ........ 8

2.1. Fusha e rrezikut: Auditimi i Brendshëm ........ 8

2.2. Fusha e rrezikut: Prokurimi Publik ........ 9

2.3. Fusha e rrezikut: Zhvillimi Ekonomik Lokal ........ 9

2.4. Fusha e rrezikut: Planifikimi Urban dhe Rural ........ 10

2.5. Fusha e rrezikut: Standardet e Ndërtimit dhe Kontrolli ........ 10

2.6. Fusha e rrezikut: Inspektimet ........ 11

2.7. Fusha e rrezikut: Arsimi Publik ........ 11

2.8. Fusha e rrezikut: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale ........ 12

2.9. Fusha e rrezikut: Shërbimet Publike dhe Licencimi i Tyre ........ 12

2.10. Fusha e rrezikut: Komunikimi me Palë të Jashtme të Interesit ........ 13

2.11. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë ........ 14

2.12. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport ........ 14

2.13. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ........ 15

## HYRJE

Komuna e Rahovecit, konform mandatit ligjor që ka dhe planit vjetor të punës për vitin 2022 ka paraparë që të harton edhe raportin për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës.

Plani i Integritetit është monitoruar nga koordinatori për monitorimin e zbatimit të tij dhe përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të pasqyruara në kuadër të këtij plani, si dhe informatat të cilat janë dhënë nga drejtorit, sektorët. Me qëllim të monitorimit të tij dhe analizës së zbatimit të masave/veprimeve, është hartuar raporti vjetor maj - dhjetor, 2022.

Raporti përfshinë periudhën maj – dhjetor, 2022 dhe përfshinë veprimet e ndërmarra në kuadër të fushave: **a).** fushave të përgjithshme të rrezikut dhe **b).** fushave të veçanta të rrezikut, të cilat janë vendosura në planin për Integritet. Andaj, edhe raporti është realizuar përmes informatave plotësuese nga ana e drejtorive. Mbi bazën e këtyre informatave, është arritur që të analizohet dhe vlerësohet gjendja aktuale e zbatimit të masave/veprimeve nga plani i veprimit.

**Metodologjia e përdorur,** gjatë monitorimit të planit të veprimit për Integritet në Komunën e Rahovecit, ka pasur një cikël të metodave:
1. Fillimisht është dërguar një email njoftues tek njësitë e komunës lidhur me veprimet dhe obligimet e tyre së bashku me planin e veprimit;
2. Janë dërguar edhe email-at rikujtues, në mënyrë që të plotësohet raporti për Planin e Integritetit;
3. Pas marrjes së planit të veprimit, janë analizuar masat/veprimet e raportuara, si dhe në fund është hartuar raporti për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Rahovecit për periudhën maj – dhjetor, 2022. Raporti është raport narrativ dhe statistikor.

**Të gjeturat**. Në bazë të informatave mbi zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit, në periudhën maj – dhjetor 2022 janë planifikuar: 2 fusha të rrezikut (1 fushë e përgjithshme dhe 1 fushë e veçantë), 17 nënfusha të rrezikut dhe 98 masa/veprime të propozuara për zbatim, nga të cilët janë zbatuar 82 masa ose 84.32%, dhe 16 masa/veprime ose 15.68% nuk janë zbatuar ose nuk janë ofruar informata adekuate, gjë që e kemi poentuar si të pazbatuara.

Sa i përket ndarjes së fushave, në kuadër të fushës së përgjithshme të rrezikut, janë 4 nënfusha të rrezikut dhe 34 masa të propozuara, nga të cilët janë zbatuar 30 dhe 4 masa ose veprime nuk janë zbatuar. Ndërsa, sa i përket fushës së rrezikut të veçantë, janë gjithësej 13 nënfusha të rrezikut dhe 64 masa të propozuara, nga të cilat 52 janë zbatuar dhe 12 masa/veprime ende jo. Për të gjitha masat/veprimet dhe informatat tjera, më poshtë i kemi dhënë sqarimet e hollësishme.

## I. Fushat e përgjithshme të rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithësej 4 nënfusha të rrezikut me gjithësej 34 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve, nga të cilat 30 masa janë zbatuar dhe 4 masa nuk janë zbatuar ose nuk janë ofruar informata nga njësitë komunale për zbatimin e tyre. Të gjitha këto të dhëna, i kemi pasqyruar si vijon:




Diagrami 1: *Progresi i arritu në fushën e përgjithshme në kuadër të zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (Maj – Dhjetor, 2022).*

### 1.1. Fusha e rrezikut: Menaxhimi

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të komunës dhe zbatimin e saj;
2. Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës;
3. Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës;
4. Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e akteve me interes publik me qëllim të përfshierjes së tyre në vendimmarrje;
5. Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
6. Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit;
7. Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit;
8. Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësime;
9. Miratimi i një akti të brendshëm për regjistrimin e raportimeve të korrupsionit brenda institucionit dhe trajtimin e tyre, si dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesëve;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e menaxhimit.**

1. *Nuk është realizuar.* Është në proces, dhe pritet shumë shpejtë të realizohet.
2. *Nuk është realizuar.*
3. Në baza ditore, bëhet përditësimi i informatave, aktiviteteve dhe lajmeve për ngjarjet që ndodhin në dhe për institucionin e komunës së Rahovecit. Transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit bëhet online në Ueb faqen zyrtare, kanalin youtobe dhe facebook.
4. Në të gjitha grupet punuese për hartimin e akteve, rregulloreve dhe planeve një anëtar i përket shoqërisë civlile. Poashtu bazuar në Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimeve publike publikohen me kohë (14 ditë para) aktet dhe rregulloret, si dhe njoftimet për konsultime publike, duke iu mundësuar secilit që të ketë mundësi të jap sugjerime dhe vërejtje dhe kështu të bëhet direkt pjesë e vendimmarrjes komunale.
5. Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. analizojnë dhe rishikojnë detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
6. Me vendim të kryetarit është caktuar Koordinatori për Integritet, i cili së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse, bën monitorimin e zbatimit të Planit për Integritet, si dhe raportimin në lidhje me zbatimin e tij.
7. Që nga caktimi i koordinatorit, janë marr masa për monitorimin dhe përditësimin e masave të zbatuara.
8. Koordinatori së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse bën rishikimin e nivelit të zbatushmërisë së masave të propozuara.
9. *Nuk është realizuar.*

## 1.2. Fusha e rrezikut: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Zhvillimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të Personelit;
2. Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit;
3. Të bëhet analiza e nevojave për trajnime;
4. Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve;
5. Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura;
6. Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës, si dhe harmonizimi i tyre me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
7. Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës;
8. Të ju ri-dorëzohet përshkrimi i vendit të punës të gjithë nënpunësve;
9. Raportimi i zbatimit të Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik, të zgjedhurit dhe të emëruarit;
10. Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit;
11. Njësia për Burime Njerëzore krijion një regjistër për regjistrimin e dhuratave të pranuara nga nëpunësit;
12. Të informohet stafit për rregullat e pranimit të dhuratave;
13. Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme;
14. Të gjithë nëpunësit publik të punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohen, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të merr përgjegjësinë përkatëse;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e politikës së burimeve njerëzore, sjelljes etike dhe profesionale të të punësuarve.**

1. Në shtator çdo vit bëhet plani i personelit, miratimi dhe zbatimi i tij.
2. Pranimi i zyrtarëve të rijnë, bëhet në bazë të kriterve të përcaktuara, në konkurse, sipas meritës;
3. Bëhet analiza e nevojave për trajnim kohë pas kohe, në bazë të analizave, nevojës për trajnim, mbahen trajnime të kohë pas kohëshme.
4. Të punësuarit në administratën komunale vazhdojnë të trajnohen varësisht sipas fushave. Për periudhën janar - nëntor 2022, janë dërguar zyrtar në IKAP (Instituti i Kosovës për Administrat Publike) për trajnim.
5. Bëhet vlersimi i ndikimeve të trajnimeve, efekti i tyre; IKAP është institucion i cili bënë vlerësimin e trajnimeve të mbajtura. Ndërsa, NJBNJ koordinon procesin e trajnimeve me IKAP. NJBNJ mbanë databazën në excel për të gjitha trajnimet e mbajtura nga IKAP, por nuk bënë vlerësim të trajnimeve pasi që kjo është në mandatin e IKAP-it. Çdo zyrtar që merr pjesë në trajnim pas përfundimit të trajnimit plotëson formularin e vlerësimit të trajnimit në IKAP.
6. Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. analizojn dhe rishikojn detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
7. Përshkrimi i vendeve të punës është realizuar dhe është harmonizuar sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe sipas Katalogut të vendeve të punës.
8. Njësia e Burimeve Njerëzore, analizon dhe rishikon detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Deri më tani është bërë rishikimi i detyrave të punës sipas Rregullores.
9. Raportohet në vazhdimsi për zbatimin e Kodit të Etikës.
10. Sipas të dhënave brenda NJBNJ-së, të gjithë zyrtarët janë të pajisur me Kodin e Etikës.
11. NJBNJ mban evidencë për dhuratat, si dhe e informon stafin për rregullat e pranimit të dhuratave.
12. Zyrtarët rregullisht informohen për rregullat e pranimit të dhuratave.
13. Mbahen takime të rregullta për prezantimin dhe diskutimin e raportimit të korrupsionit, dhe të aktiviteteve të tjera të pa ligjëshme.
14. *Nuk është realizuar.*

## 1.3. Fusha e rrezikut: Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit;
2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit;
3. Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve financiare;
4. Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore;
5. Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës;
6. Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit;
7. Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit;
8. Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe financave**

1. Kryetari i Komunës së bashku me drejtorët e drejtorive relevante mban dëgjime buxhetore në bazë të ligjit, në të gjitha vendbanimet e Komunës, me OJQ, Sindikata, Biznese etj.

2. Me vendim te ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) dhe ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) përzgjidhen punonjësit e Komunës qe të ndjekin trajnimet në modulet: shpenzues, zotues, pranues etj.
3. Vazhdohet hartimi më i detajuar në mënyrë që miratimi i raporteve të shpenzimeve të kryhet ashtu siç është bërë planifikimi i buxhetit.
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e bënë raportimin e rregullt të shpenzimeve buxhetore në bazë të raporteve periodike.
5. Këto raporte gjithmonë publikohen në ueb faqen e Komunës.
6. Drejtoria për Buxhet dhe Financa përkatësisht zyrtari kryesor financiar i prezanton raportet financiare në secilin tremujor.
7. Drejtoria për Buxhet dhe Financa përpilon dhe raporton, raporte financiare në baza mujore.
8. Në vazhdimësi bëhet përditësimi i aseteve komunale nga zyrtari përgjegjës.

## 1.4. Fusha e rrezikut: Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative;
2. Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikun nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara;
3. Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave dhe dokumentacionit**

1. Në vazhdimësi përdoret sistemi i intranetit për krijimin e kërkesave, procesimin e kërkesës deri tek përfundimi i lëndës dhe njoftimin e palës për atë lëndë, pastaj është po ashtu platforma konkursi online (https://konkursi.rks-gov.net), ku zhvillohen procedurat për aplikim dhe njoftim, në platformën e-kosova ofrohen shërbime për nxjerrjen e faturës së tatimit në pronë, gjendjes civile, taksa komunale (https://ekosova.rks-gov.net/Services).
2. Në vazhdimësi punonjësit informohen nga ASHI (Agjencioni Shtetror i Kosovës) dhe stafi i TIK-ut (Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit) kur ka tentime të mashtrimeve.
3. Pikënisja e procedurës është qendra për shërbim të qytetarëve, ku fillon procedura e kërkesave nga personat zyrtarë apo juridik, zhvillohet procedura e brendëshme për realizimin e kërkesës (trajtohet nga departamenti përkatës) dhe pas përfundimit jepet informacioni mbi lëndën e trajtuar.

## II. Fushat e veçanta të rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithsej 13 nënfusha të rrezikut me gjithësej 64 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve nga të cilat 52 janë të realizuara dhe në proces janë edhe 12 masa, si vijon:




Diagrami 2: *Progresi i arritur fushën e veçantë në kuadër zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (Maj – Dhjetor, 2022)*

### 2.1. Fusha e rrezikut: Auditimi i Brendshëm

**<u>Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve</u>**

1. Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevoje;
2. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë kontrollave;
3. Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
4. Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
5. Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale;
6. Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuara procedurale;

**<u>Veprimet për zbatimin e masave në fushën e auditimit</u>**

1. Ekziston Plani i cili bazohet në vlerësimin e rrezikut. Me Planin e vitit 2022 janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara dhe plani është monitoruar dhe realizuar në 100%.
2. Bëhen auditime rast pas rasti.
3. Ekziston plani për zbatimin e rekomandimeve.
4. Raportim i rregullt në bazë të planit për implementimin e rekomandimeve të AB.

5. Njësia e AB, Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës kanë komunikim të rregullt.
6. Auditimet bëhen sipas planit të punës së njësisë së auditimit të brendshëm dhe sipas rastit.

## 2.2. Fusha e rrezikut: Prokurimi Publik

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit, duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë;
2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik;
3. Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës;
4. Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit;
5. Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e prokurimit publik**

1. Përmirësimi i dukshëm i specifikave teknike dhe jo favorizimi i specifikave, duke pasur qasje të barabart.
2. ***Nuk është realizuar.*** Nuk ka pasur ndonjë trajnim për prokurim publik.
3. Në vazhdimësi publikohet plani, sipas datave të Ligjit të Prokurimit.
4. Janë të caktuara pika të qarta të kontaktit, nëpërmjet sistemit të Prokurimit Elektronik
5. ***Nuk është realizuar.***

## 2.3. Fusha e rrezikut: Zhvillimi Ekonomik Lokal

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Hartimi, rishikimi, përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës;
2. Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës;
3. Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal;
4. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive;
5. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve;
6. Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal;
7. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimin ekonomik lokal;
8. Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e zhvillimit ekonomik.**

1. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka të miratuar Strategjin e Zhvillimit, Ekonomik Lokal, e cila zbatohet në vazhdimësi.
2. Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik bëhet në vazhdimësi.
3. Poashtu gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit ekonomik komunal, marrin pjesë të gjitha palët relevante.
4. Në bazë të rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve. Në rregulloren Nr. 1427 të datës 28/04/2017, janë të përcaktuara kriteret dhe proceduarat për ndarjen e subvencioneve.

5. Në të gjitha komisionet për vlerësimin e kërkesave merr pjesë një anëtar/e nga shoqëria civile.
6. Në kuadër të drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, është zyrtari për zhvillim ekonomik.
7. Zyrtari për zhvillim ekonomik lokal, mban trajnime të vazhdueshme nga ministritë e linjës dhe organizatat të tjera vendore dhe ndërkombëtare.
8. Kontrollimi dhe raportimi për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal bëhet në baza periodike, mujore, 6 mujore dhe vjetore.

## 2.4. Fusha e rrezikut: Planifikimi Urban dhe Rural

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive;
2. Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullativës së brendshme;
3. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural;
4. Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural;
5. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural;
6. Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e planifikimit urban dhe rural.**

1. ***Nuk është realizuar***. Është në proces të miratimit PZHK (Plani Zhvillimor i Komunës) dhe HZK- (Harta Zonale e Komunës) të cilat do të rregullojnë procesin e dhënies së lejeve ndërtimore.
2. Me vendim të Kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar zyrtarë përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje për rrënim.
3. Për të gjithë zyrtarët sigurohet trajnim i nevojshëm.
4. Është siguruar personel adekuat dhe profesional për planifikimin urban dhe rural.
5. Është bërë trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural.
6. Bëhet kontroll dhe raportim i rregullt për mënyrën e zbatimit të aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural.

## 2.5. Fusha e rrezikut: Standardet e Ndërtimit dhe Kontrolli

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje;
2. Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural;
3. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e ndërtimit dhe kontrollit**

1. Në bashkëpunim me drejtorinë e Inspektoratit janë duke u bërë kontrolla në teren.
2. Me vendim të Kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar zyrtarët përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje për rrënim.
3. Në bashkëpunim me Njësinë për Burime Njerëzore, organizohen trajnime të ndryshme, edhe këtë vit janë organizuar trajnime për stafin.

## 2.6. Fusha e rrezikut: Inspektimet

**Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve**

1. Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut;
2. Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët;
3. Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja;
4. Fuqizimi i sistemit të kontrolleve mbi funksionimin e operatorëve të biznesit. Të rriten gjobat për operatorët pa regjistrim dhe licenca valide të biznesit;
5. Ka nevojë që në D.I të publikojë në baza vjetore listën e bizneseve të inspektuara dhe shpeshtësinë e inspektimeve;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e inspektimit.**

1. ***Nuk është realizuar.*** Sepse bëhen inspektime të kohë pas kohëshme sipas nevojës dhe nuk ka një plan vjetor paraprak.
2. ***Nuk është realizuar.*** Nuk janë organizuar trajnime profesionale.
3. Është plotësuar numri, janë pranuar dy inspektorë në muajin qershor, një në sektorin e ndërtimit dhe një për çështje komunale.
4. Bëhet inspektimi në vazhdimësi i operatorëve ekonomik, janë lëshuar 70 licenca valide të biznesit, pra janë regjistruar 70 biznese të paregjistruara.
5. Egziston një listë me biznese të inspektuara dhe në fund të vitit bëhet publikimi në ueb faqe.

## 2.7. Fusha e rrezikut: Arsimi Publik

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Të sigurohet planifikim i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes së numrit të nxënësve;
2. Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij;
3. Rekrutimi i stafit të duhur arsimor, kujdesi i veçantë në marrjen e stafit për zonat ku ka nevojë; urgjente. Rishikimi i procedurave operacionale për rekrutimin e stafit në sektorin e edukimit për të siguruar kontrolle adekuate të integritetit, p.sh. përfshirja e OJQ-ve, aktorëve të tjerë të jashtëm në panelet intervistuese, dhe rritja e transparencës së procesit të intervistimit, rritja e publicitetit të rezultateve të përzgjedhjes;
4. Përmirësimi i sigurisë fizike të shkollave me rekrutimin e stafit profesional të sigurisë;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e arsimit publik.**

1. Ka filluar të implementohet gjatë vitit 2022 me punësimin e asistenteve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore (që është bërë në muajin shtator të vitit 2022) dhe do të vazhdohet me rekrutimet për shërbimet pedagogjiko-psikologjike për vitin shkollor 2022/2023.
2. Në kuadër të përgjegjësive që ka, DKA në vazhdimësi inspekton dhe mbikëqyr procesin edukativo arsimor dhe ky proces i inspektimeve bëhet çdo javë, përmes vizitave sistematike që realizojnë zyrtarët e DKA-së në shkolla. Ndërkohë, inspektime të kohë pas kohshme bëhen edhe nga Zyrat Rajonale të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë dhe Prizren.

3. DKA, në vazhdimësi, në mënyrë periodike hap konkurse dhe zhvillon procedurat e rekrutimeve adekuate për plotësimin e vendeve të lira të punës, varësisht nga nevojat që ka. Procedurat e rekrutimeve zhvillohen në përputhje me Udhëzimet Administrative të MASHTI-t.
4. ***Nuk është realizuar.*** Siguria fizike e objekteve shkollore nuk është e paraparë me buxhetin komunal, d.m.th, nuk ka të punësuar që ruajnë dhe kujdesen për objektet e shkollave, por nga 36 objekte shkollore që ka komuna jonë, deri në shtatorin e vitit 2022, 25 objekte të shkollave janë pajisur me kamera të sigurisë, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e sigurisë fizike të shkollave.

## 2.8. Fusha e rrezikut: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Rishikimi dhe revidimi i prioriteteve për përmirësime në infrastrukturë dhe sigurimin e hapësirave të nevojshme për shërbime shëndetësore;
2. Të rishikohet rregullativa e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit;
3. Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullativës;
4. Rritja e transparencës në punën e Qendrës për Punë Sociale, përmes mundësimit të qasjes në informata në ueb faqe të saj lidhur me aktivitetet e kryera me informata të plota;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale**

1. ***Nuk është realizuar.*** Është në proces, pasi është paraparë që të realizohet në periudhën 2022/2023.
2. ***Nuk është realizuar.*** Është në proces, pasi është paraparë që të realizohet në periudhën 2022/2023.
3. ***Nuk është realizuar.***
4. Qendra për Punë Sociale është transparente në punën e saj dhe bënë raporte në vazhdimsi si dhe e lejon qasje në informata për palët që janë të interesuara për punën e saj.

## 2.9. Fusha e rrezikut: Shërbimet Publike dhe Licencimi i Tyre

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Të zhvillohen aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për lejet për shërbimet përkatëse publike;
2. Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike;
3. Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër);
4. Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave, punëtorive;
5. Rritja e rrezikut në menaxhimin e mbeturinave; përmirësimi i kornizës strategjike me hartimin dhe miratimin e një rregulloreje komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, sigurimi i kontrolleve strikte dhe i llogaridhënies së operatorëve;
6. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit të cilat parandalojnë vendime subjektive;
7. Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e shërbimeve publike dhe licencimit të tyre.**

1. Janë zhvilluar akte nënligjore si dhe në vazhdimësi janë qartësuar procedurat për lejet për shërbimet përkatëse, janë lëshuar leje per shërbime sipas akteve dhe procedurave ligjore. Duke respektuar udhëzimet, dhe rregulloret komunale.
2. ***Nuk është realizuar.*** Është duke u punuar në platformën e-komuna ku do të lanësohen shërbimet komunale (Në vazhdimësi).
3. Vazhdimisht zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendime, kjo praktikë zbatohet në vazhdimësi, të gjitha shërbimet kryhen shpejtë dhe pa asnjë pengesë burokratike.
4. Në çdo trajnim dhe në çdo shkëmbim përvojash marrin pjesë, përveç zyrtareve po ashtu edhe udhëheqësit e drejtorisë.
5. Vazhdimisht komuna ka përcjell ecurinë e planeve komunale për menaxhim të mbeturinave. Po ashtu ka raportuar në baza mujore dhe vjetore në drejtori, dhe sipas kërkesave që kërkon MMPH. Komuna jonë ka të hartuar planin komunal për menaxhimin e mbeturinave si dhe dy plane të tjera për menaxhimin e mbeturinave.
6. ***Nuk është realizuar.*** Kjo do të jetë vazhdimësi e vitit 2022/23.
7. Ne vazhdimësi bëhet trajnimi i stafit në disa sektorë.

## 2.10. Fusha e rrezikut: Komunikimi me Palë të Jashtme të Interesit

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt-rregulloreve në ueb-faqe, inicimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj;
2. Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve;
3. Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative
4. Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e komunikimit me palë të jashtme të interesit.**

1. Në të gjitha proceset e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike për këtë 9 mujor, u bë njoftimi me kohë ashtu siç parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standartet Minimale të konsultimeve publike, 14 ditë para në ueb faqen zyrtare, në rrjetet sociale si dhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë. Gjithashtu vendoset njoftimi i afishuar në hyrje të objektit komunal. Të gjitha dokumentet që futen në konsultime publike publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës duke qenë të qasshme për publikun, konsultohen palët e interesit si dhe kryhen procedurat në tërësi siç parashihen me gjithë, duke publikuar procesverbale dhe raporte nga proceset e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike
2. Në të gjitha grupet punuese dhe vendimet që merr kryetari i Komunës, një anëtar i përket shoqërisë civile duke i përfshirë direkt në proceset vendimmarrëse.
3. Në të gjitha proceset e takimeve publike, dëgjimeve buxhetore, bizneset janë thirrur veçanërisht duke i konsultuar dhe duke marrë kërkesa nga ta. Dëshmi keni njoftimet dhe procesverbalet në https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/degjime-buxhetore-al/
4. Për të gjitha aktivitetet janë të njoftuara mediat dhe publiku në tërësi në kohë reale.

## 2.11. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Rritja e përdorimit të e-shërbimit dhe monitorimi elektronik i dokumenteve, të rritet transparenca;
2. Rritja e zhvillimit profesional i stafit sipas nevojës. Ofrimi i trajnimeve rifreskuese/të vazhdueshme për rregullat e reja ose kornizat për matje kadastrale. Licencimi i KP për gjeodezi e ka lehtësuar punën e matjes në teren;
3. Ofrimi i trajnimeve rifreskuese/të vazhdueshme për rregullat e reja ose kornizat për matje kadastrale;
4. Licencimi i KP për gjeodezi e ka lehtësuar punën e matjes në teren;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e drejtoris për gjeodezi, kadaster dhe Pronë.**

1. Kërkesat për përdorimin e e-shërbimeve janë të vazhdueshme, monitorimi i dokumenteve dhe skenimi bëhet në vazhdimësi nga ZKK-të (Zyra Kadastrale e Komunës) dhe AKK-të (Agjencioni Kadastralel i Kosovës).
2. Zhvillimi profesional i stafit është i vazhdueshëm dhe bëhet sipas nevojës.
3. Trajnimet dhe rregullat e reja mbahen vazhdueshëm nga AKK për ZKK.
4. AKK gjatë gjithë kohës vazhdojnë të licencojnë KP (Kompani Private).

## 2.12. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Ndërmarrja e masave për përzgjedhjen e rregullt të OJQ-ve dhe organizatave sportive;
2. Përmirësimi i kornizës strategjike për Kulturë, Rini dhe Sport duke hartuar Planin e Veprimit Komunal për Rini, Kulturë dhe Sport. Të gjitha aktivitetet kulturore sportive dhe rinore, të planifikohen me buxhet për çdo vit nga DKRS-ja;
3. Krijimi i një programi specifik për forcimin e kapaciteteve për punëdhënësit sportiv, si dhe për personat përgjegjës për menaxhimin e zonave sportive. Të sigurohet se menaxhimi i integritetit të bëhet pjesë e saj. DKRS, siguron mjetet financiare nga kategoria e subvencioneve për klube sportive OJQ dhe nga aspekti infrastrukturor me objekte dhe hapësira për zhvillim të aktiviteteve;
4. Zbatimi i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë dhe fushat për të rinjtë;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e Drejtoris për Kultur, Rini dhe Sport.**

1. Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione për OJQ-të, të cilat operojnë në territorin e Komunës së Rahovecit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bënë: Ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të Klubeve, Shoqatave dhe OJQ-ve, organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Rahovecit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bënë thirrje të gjitha, Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
2. ***Nuk është realizuar.*** Plani i kornizës strategjike të planifikimit të buxhetit për aktivitetet kulturore, sportive e rinore është në proces të finalizimit për vitin 2023.

3. Me gjithë përpjekjet e reformës, ka ende një mungesë të theksuar, burimet (resurset) materiale më të rëndësishme në sport janë objektet sportive. Objekti sportiv është hapësirë në (mbi) të cilat kryhet aktiviteti sportiv. Ato me strukturën e tyre, përdorimin e caktuar, statusin funksional, të planifikimit dhe programimit në përgatitjen e programeve sportive në të gjitha nivelet që ka të bëjë me këto resurse. Në mesin e objekteve sportive vend të veçantë zënë qendrat sportive si komplekse për zhvillimin e aktiviteteve dhe shprehjen e talentit të të rinjëve si (aktivitete sportive dhe arsimore, garuese-sportive sportive-rekreative, sportive shkollore) dhe për kategoritë e ndryshme të përdoruesve (fëmijët , adoleshentët, të rriturit, personat me nevoja të veçanta).
4. Zbatimi i programeve të integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

## 2.13. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

**Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve**

1. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive;
2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve;
3. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me menaxhimin e rreziqeve specifike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe rreth burimeve alternative të ngrohjes;
4. Rritja e kontrollit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe përdorimit të tokës;

**Veprimet për zbatimin e masave në fushën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.**

1. Vazhdimisht zbatohet rregullorja për ndarjen e subvencioneve.
2. Në secilin komision të shpërndarjes së subvencioneve përfshihet një anëtar i shoqërisë civile.
3. Ne kuadër te DBPZHR-se funksionon faqja në rrjetin social facebook përmes te cilës shpërndahet mesazh vetëdijesues për qytetaret e komunës tonë, si në këshillim të kultivimit të pemëve dhe perimeve e poashtu edhe në rastet e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore. Poashtu janë organizuar edhe takime të ndryshme për sektorët e përpunimit dhe konservimit të pemëve dhe perimeve.
4. Në bashkëpunim me MBPZHR çdo vit bëhet përzgjedhja e fermerëve që sigurojnë mostra për analiza të dheut dhe kjo përmes departamentit te shërbimeve këshillimore.

Koordinatori për integritet

Valmir Gashi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 00.11.2022 merr këtë:

**VENDIM**
**Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 66/20 i datës 30.04.2020 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, respektivisht pronave P-71510057-02279-0, P-71510057-02280-0 dhe P-71510057-02281-0.

2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
   **2.1.** _______________, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
   **2.2.** _______________, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
   **2.3.** _______________, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
   **2.4.** _______________, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
   **2.5.** _______________, përfaqësues nga sektori joqeveritar.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 5 (pesë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.

4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.

6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.

8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.

9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivi***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

**01- Nr. ___/22**
**Datë:00.11.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/166 Nr. i fq/Br.str/No.pg —
Data/Datum/Date 30/04/2020

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina në Republikën e Kosovës, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 07/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Demolimi i Objekteve Ndërtimore, nenit 10, 39, 40, 46, 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.04.2020 merr këtë:

**V E N D I M**
**Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër**

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 434/04/2020 i datës 10.04.2020 dhe merret vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, janë në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Gavne Shume, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 116186 $m^2$ (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë metra katror) me numër te certifikatës së pronësisë si më poshtë:
   2.1. Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02279-0, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 42737 $m^2$.
   2.1 . Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02280-0, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 62661 $m^2$.
   2.2 Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02281-0, jo pjellore me sipërfaqe prej 10788 $m^2$

3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor me qëllim të ruajtjes së mjedisit duke pasur në konsideratë kontrollin dhe menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave të ngurta si dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatshkurtër në periudhën deri 5 (pesë) vite.
5. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01. Nr.576 datë 28.02.2017 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba.
8. Obligohen Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr. 66/2020**
**Me datë: 30.04.2020**

**Afrim Dina**
**Kryesuesi i Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA - KUVENDI I KOMUNËS / MUNICIPAL ASSEMBLY - RAHOVEC / ORAHOVAC